



Republika e Kosovës-Republika Kosova-Republic of
Kosovo

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
Regulativni Autoritet Železnica
Railway Regulatory Authority



RAPORT VJETOR 2011



Përmbledhje ekzekutive

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) është themeluar në bazë të ligjit Nr. 03/L-076 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës i cili është miratuar nga Kuvendi në qershor 2008. Ky ligj aplikohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë. Si dhe parasheh themelimin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave si bartës kryesor për zbatimin e këtij ligji. Po ashtu Ligji Nr. 03/L-076 rregullon licencimin, certifikimin, sigurinë, interoperabilitetin, hulumtimin e aksidenteve, rregullimin e tregut dhe lëshimin e lejeve që kanë të bëjnë me veprimtaritë hekurudhore në Kosovë.

Qëllimi i këtij dokumenti është të raportoj në bazë vjetore sipas ligjit ne fuqi per progresin e bërë ne ARH dhe informimin per ngjarjet kryesore per sektorin e hekurudhave per periudhën nga janar 2011 deri në dhjetor 2011.

ARH ka filluar punën në vitin 2010, në bazë të ligjit nr 03-L/076 për hekurudhat ne vitin 2008. Ligji hekurudhave i ka atribuar të gjitha përgjegjësitë e mundshme rregullatore ARH-së, duke përfshirë Hetimin e Aksidenteve Licencimin e Operatorëve dhe Infrastrukturës, Interoperabilitetin, Autoritetin e Sigurisë Rregullimin e tregut (çështjet e konkurrencës dhe çështjet e klienteve) Qasjen në Trase. Diskutimet dhe reagimet e ARH-se kane qene te vazhdueshme gjate tere vitit ne raport me grupet e ndryshme punuese gjatë procesit të rishikimit të Ligjit hekurudhave, i cili tash është aprovuar ne Kuvend. Ndër ndryshimet që jane pritur eshte: • Hetimi i Aksidenteve do të kaloj ne KHAIA (të jenë në përputhje me doktrinën e BE-së, që thotë se Autoriteti i Sigurisë nuk mund të jetë në të njetin institucion me Hetimin e Aksidenteve) • Çështjet e konkurrencës dhe tregu janë në përgjegjësi te ARH-se. ARH me qellim te harmonizimit te kornizes ligjore ka filluar bashkpunimin me institucionet tjera përgjegjëse për konkurencen dhe tregun Republikën e Kosovës siq eshte Komisioni i Konkurences në mënyrë që i tërë sistemi rregullator te funksionojë i koordinuar dhe në përputhje me standardet dhe praktikat më të mira ndërkombëtare. ARH ka pergatitur draftin e Memorandumin e Mirëkuptimit me kete institucion dhe eshte duke pritur pergjigjen nga ky institucion.

Sektori hekurudhor në Kosovë edhe këtë vit në përgjithësi ka vazhduar me procesin e ristrukturimit kryesisht rreth infrastrukturës ligjore, në mënyrë që të ndjekë rekomandimet e BE-së për transportin hekurudhor dhe integritetin ne regjion e më gjerë. Bazuar ne kete konstatim ARH ka dhene nje kontribut te çmuar si institucion me kompetence per sektorin hekurudhor. Aktiviteti hekurudhor në Kosovë deri tani ka qene i përqëndruar në një kompani unike (Hekurudhat e Kosoves), me një staf prej rreth 460 punonjës dhe një transportim gjate vitit 2011 prej 357725 pasagjerë dhe 1,035,066 ton të mallrave. Hekurudhat e Kosovës tani jane ndarë në dy subjekte juridike me pronesi publike (Menaxhimi i Infrastruktures dhe Operimi me Trena) Ky proces i ndarjes ka filluar me vendimin nr.718 të datës 03.06.2010 të Ministrit të Financave ku ARH ka qenë e përfaqesuar ne cilesine e vëzhguesit ne Grupin Punues për procesin e ndarjes. Ky akt ka hapur rrugën për lindjen e ndërmarrjeve të reja hekurudhore në Kosovë, kompanive private dhe / ose publike, ndersa që të gjithë do të mund ta perdorin infrastrukturën e cila do vazhdoj të jetë në pronësi publike. Një proces i tillë i liberalizimit, që të jetë efikas ka nevojë për një strukturë të re rregullative.

Përmbajtja	2
1. Hyrje	4
2. Struktura organizative e ARH -së	8
2.1.Bordi Drejtues i ARH-së.....	8
2.2. Menaxhmenti.....	9
2.3.Departamenti i Administratës.....	10
2.4. Divizioni i Financave.....	15
2.5.Departamenti Ligjor dhe i Licensimit.....	16
2.6.Departamenti i Hulumtimit të Aksidenteve.....	17
2.7.Departamenti i Interoperabilitetit.....	17
2.8.Departamenti i Sigurisë.....	18
2.9.Departamenti i Zhvillimit të Tregut.....	19
3. Rekrutimi i stafit të ARH-së gjatë vitit 2011.....;	19
4. Buxheti dhe shpenzimet e ARH-së 2011.....	19
5. Prokurimi.....	20
6. Përkrahja për zbatimin e Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit (EU TCA).....	21
6.1. Marrëveshja nderkufitare me Maqedonine.....	23
6.2. Asistenca Teknike për ARH-ne.....	23
6.3. IPA Projekti.....	24
7. Gjendja aktuale dhe zhvillimet e ardhshme të Hekurudhave të Kosovës.....	25
7.1. Ndarja e Hekurudhave të Kosovës.....	26
7.1.1.Trainkos.....	27
7.1.2.Infrakos.....	28
8. Aktivitetet e ARH-se.....	29
8.1. Licensimi dhe Legjislacioni.....	30
8.1.1. Aktet nenligjore.....	32
8.1.2. Direktivat e komisionit Evropian.....	33
8.2. ARH ne funksion te Sigurisë.....	36
8.2.1. Inspektimet ne teren.....	37
8.3. ARH ne funksion te Rregullimit te Tregut.....	38
8.3.1. Memorandumi me Komisionin e Konkurences.....	40
9. Ceshtjet teknike dhe hetimi i aksidenteve.....	41
10. ARH ne Region.....	45
10.1. Tryeza e Rrumbllaket ne Kroaci.....	47
10.2. SETTO.....	50
11. Kerkesat per buxhet dhe perkrahje.....	57
12. Anekset.....	58

Akronimet dhe shkurtesat

ARH	Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave
ZNKE	Zyra Nderlidhese e Komisionit Evropian
DB	Deutsche Bahn AG
CFL	Chemins de Fer Luxembourgeois
KE	Komisioni Evropian
ERA	Agjencia Hekurudhore Evropiane
EU	Union Evropian
IPA	Instrumenti i Para-antaresimit
DPSA	Dialogu për Procesin e Stabilizim Asocimit (DPSA)
HK	Hekurudhat e Kosovës
MI	Menaxheri i Infrastrukturës
KKK	Komisioni i Konkurrencës i Kosovës
LH	Ligji numër 03/L-076 për Hekurudhat në Republikën e Kosovës
MI	Ministria e Infrastruktures
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
MIE	Ministria e Integrimeve Evropiane
MF	Ministria e Financave
REBIS	Studimi i Infrastrukturës Rajonale të Ballkanit
TRAINKOS	Operatori i hekurudhave
INFRAKOS	Infrastruktura Hekurudhore
CRTN	Rrjeti Themelor i Transportit Rajonal
EU	Unioni (Bashkimi) Evropian
FH	Plotësisht i harmonizuar (Gap Analiza Ligjore)
MoU	Memorandumi i Mirëkuptimit i Observatorit të Transportit të Evropës Juglindore
PH	Pjesërisht i harmonizuar (Gap Analiza Ligjore)
EJ	Evropa Juglindore
SEETO	Observatori i Transportit i Evropës Juglindore
TSI	Specifikimet teknike për Interoperabilitetin
GP	Grupi Punues
TCA	Marrëveshja e Komunitetit të Transportit
UIC	Unioni Ndërkombetar i hekurudhave Rregullatorit i Hekurudhave të Kroacisë
STMM	Strategjia e Transportit Multi Modal

1. Hyrje

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) është themeluar në bazë të ligjit Nr. 03/L-076 për Hekurudhat e Republikës së Kosovës i cili është miratuar nga Kuvendi në qershor 2008. Ky ligj aplikohet për funksionimin, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e hekurudhave të Kosovës dhe infrastrukturës së saj dhe për të gjitha operimet e trenave që shfrytëzojnë këtë infrastrukturë. Si dhe parasheh themelimin e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave si bartës kryesor për zbatimin e këtij ligji. Po ashtu Ligji Nr. 03/L-076 rregullon licencimin, certifikimin, sigurinë, interoperabilitetin, hulumtimin e aksidenteve, rregullimin e tregut dhe lëshimin e lejeve që kanë të bëjnë me veprimtaritë hekurudhore në Kosovë.

Përgjegjësitë dhe funksionet e ARH-së.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave në bazë të Ligji Nr. 03/L-076 ka përgjegjësi të mbikëqyrë dhe rregullojë sektorin e hekurudhave në Kosovë duke lejuar zhvillimin e këtij sektori në bazë të urdhëresave evropiane mbi hekurudhat të cilat janë të përshtatshme për Kosovën.

Në pajtim me LH, ARH-ja do të:

nxjerrë, revokojë dhe mbikëqyrë përputhshmërinë me licencat, certifikatat e sigurisë dhe lejet, nxjerrë rregullat dhe formularët e përshkruar lidhur me paraqitjen e kërkesës dhe kushtet për licenca, certifikata të sigurisë dhe leje, miratojë pranimin e pajisjeve hekurudhore lidhur me sigurinë dhe Interoperabilitetin, nxjerrë rregulla për sigurinë dhe Interoperabilitetin e sistemit të hekurudhave dhe do të mbikëqyrë pajtueshmërinë me këto rregulla, kryejë dhe raportojë mbi inspektimet e sigurisë, shqyrtojë dhe vendosë mbi ankesat e bëra nga operatori hekurudhor lidhur me një vendim të menaxherit të infrastrukturës dhe do të nxjerrë procedura për ankesat e tilla, zbatojë dhe raportojë hetimet e fatkeqësive dhe do të nxjerrë procedura përmes të cilave do të zbatohen hetimet e fatkeqësive; mbikëqyrë dhe do t'i ofrojë informacione Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Infrastrukturës lidhur me zhvillimet në sektorin hekurudhor, çështjeve të ngjashme mbi sigurinë dhe kushtet e tregut për hekurudhat në Kosovë, me synim të paraqitjes së konkurrencës ndërmjet operatorëve hekurudhorë dhe bëjë rekomandime drejtuar Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe Ministrisë së Infrastrukturës lidhur me zhvillimet në sektorin hekurudhor, duke përfshirë edhe legjislacionin për të promovuar konkurrencë të drejtë dhe jodiskriminuese dhe t'i sigurojë Kuvendit të Republikës së Kosovës e Ministrisë së Infrastrukturës të gjitha informacionet relevante dhe të nevojshme për vlerësimin e rekomandimeve të tilla.

2. STRUKTURA ORGANIZATIVE E ARH-se

ARH në përberjen e vet ka bordin drejtues, drejtorin e përgjithshëm i cili është edhe anëtar i bordit zëvendës-drejtorin e përgjithshëm, si dhe personel tjetër profesional dhe administrative, ne vazhdim te ketij raporti do japim detajet e struktures organizative te institucionit.

2.1. BORDI DREJTUES I ARH-se

Në prill te vitit 2010 Kuvendi i Republikës së Kosovës ka emëruar tre anëtarët e bordit me vendimin nr.03-V-271 të datës 01.04.2010 me mandat kater vjeqar. Bordi i ARH-së përbëhet nga katër anëtar, tre anëtar janë të emëruar nga Kuvendi ndersa anetari i katert eshte edhe Drejtori i Pergjithshem qe eshte perzgjedhur nga Bordi i ARH-së me vendimin nr.001/2010 të datës 30.06.2010.

Bordi i ARH-së aktivitetetin e vet e ushtron çdo dite dhe është përgjegjes për:

Përgatitjen dhe miratimin e procedurave dhe politikave të brendshme për funksionim të Autoritetit dhe të Bordit; miratimin e propozimeve buxhetore, raporteve financiare, raporteve ose informacioneve të tjera që duhet siguruar nga Autoriteti në pajtim me Ligjin mbi menaxhim financave publike dhe përgjegjësitë nr. 03/L-048 dhe të gjitha instrumentet tjera plotësuese të nxjerra më pastaj; miratimit të çdo transaksioni në pajtim me ligjin në fuqi dhe i dokumentacionit lidhur me: prokurimin e mallrave, shërbimeve dhe punëve;huazimin e parave; zgjatjen e afatit të huasë apo themelimin e instrumentit të kredisë; nxjerrjen e instrumenteve që shqiptojnë obligimin e borxhit mbi Autoritetin;garancinë, dëmshpërblimin apo sigurime të tjera për pagimin e borxheve të palës së tretë ose përvetësimin e pasurisë së luajtshme a të paluajtshme os interesimit të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në ndonjë ndërmarrje të cilësdo natyre;miratimit të pagimit të kompensimit ose shlyerjes si rezultat i procedurës ligjore të inicuar ndaj Autoritetit në një gjykatë kompetente; emërimit dhe shkarkimit të drejtorit të përgjithshëm;dhënien dhe revokimin e licencave, certifikatave të sigurisë dhe lejeve, nxjerrjen e rregullave dhe formularëve të përshkruar për paraqitje të kërkesës dhe kushteve për licenca, certifikata të sigurisë dhe lejeve;shqyrtimin dhe marrjen e vendimeve mbi ankesat lidhur me vendimet e menaxherit të infrastrukturës; nxjerrjen së procedurave për ankesat mbi vendimet e menaxherit të infrastrukturës; miratimin dhe tërheqjen së miratimeve për pajisjet hekurudhore; miratimit të përcaktimeve të fakteve, vendimeve dhe rekomandimeve mbi hetimin e një fatkeqësie ose inspektimin e sigurisë dhe përgatitjen e raporteve përfundimtare; nxjerrjes së procedurave për zbatimin e hetimeve të fatkeqësive; rekomandimit drejtuar Kuvendit dhe Ministrisë lidhur me zhvillimin e sektorit hekurudhor, në veçanti paraqitjen e konkurrencës ndërmjet operatorëve hekurudhorë me heqjen e kufizimeve në lejimin e itinerarit të trenave etj.

2.2. MENAXHMENTI

Drejtori i përgjithshëm është edhe kryeshef ekzekutiv i Autoritetit dhe anetar i bordit. Drejtori i përgjithshëm është emëruar nga Bordi. Drejtori i përgjithshëm ushtron kompetencat që i delegohen atij nga Bordi dhe nga ky Ligj dhe është përgjegjës për: drejtimin e punëve të zakonshme të Autoritetit në pajtim me politikat dhe udhëzimet nxjerra nga Bordi; emërimin dhe shkarkimin e anëtarëve të personelit në pajtim me politikat dhe procedurat e brendshme dhe ligjin në fuqi; sigurimin e informacioneve për Bordin lidhur me çështjet e diskutuara në mbledhjet e Bordit dhe sigurimin e zbatimit të vendimeve të Bordit.

Menaxhon me departamentet në kuader të ARH-se dhe i rekomandon Bordit

2.3. DEPARTAMENTI I ADMINISTRATËS

Departamenti të Administratës ka luajtur rolin udhëheqës në sigurimin e funksionimit optimal administrativ, administrimin ditor që bëhet në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave (ARH) drejtpërdrejt ka qenë përgjegjës për menaxhimin dhe mbikëqyrjen e stafit administrativ të ARH-së, si dhe ka dhënë mbështetje në konsulencë. Ka menaxhuar në mënyrë efektive administrimin e aktiviteteve të burimeve njerëzore siç janë: administrimi i kohës dhe prezencës në punë, rekrutimi, vendosja e shpalljeve për punë, vlerësimet e punës së stafit të ARH-së. Në mungesë të stafit financiar, ky departament është certifikuar nga Ministra e Financave, departamenti i thesarit për zyrtar pranues të lendeve financiare.

Zyra administrative ka ofruar përkrahje administrative për të gjitha departamentet e tjera të ARH-së, po ashtu dhe të Bordit, për një funksionim efikas të ARH-së.

2.4. DIVIZIONI I FINANCËVE

Divizioni i Financave ka rol kyq në menaxhimin me të hyrat dhe shpenzimet, pra siguron që paraja publike të shpenzohet në mënyrë sa më të arsyeshme dhe konform rregullave të buxhetit të konsoliduar të Republikës së Kosovës. Në të gjitha kategoritë e shpenzimeve buxhetore, kapitale dhe operative, menaxhimit financiar, kontabilitetit, përgjegjësi buxhetore dhe sistemit të raportimit financiar.

Divizioni i Financave në Autoritetin Rregullativ të Hekurudhave vepron dhe operon në bazë të: Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë. Divizionit i Financave përgatitë planifikimin e buxhetit të ARH-se sipas kërkesave ligjore dhe vendimeve të ARH-së, Përgatitja e raporteve financiare, Mbikëqyrjen e Zotimeve, pranimeve, shpenzimeve dhe certifikimeve të lëndëve në sistem të Free Balancit-it, Përgatitja e raporteve standarde të të hyrave dhe shpenzimeve, Nxjerrja e raporteve, analiza dhe shqyrtimi i bilanceve dhe shërbimeve të përgjegjësisë financiare, Mbarëvajtja e procedurave dhe sistemeve adekuate financiare të BKK-së, përfshirë sistemin e pagesës së rrogave dhe shtesave të punëtorëve, Mbajtja e llogarisë së kontabilitetit në mënyrë të pavarur. Krijimi i sistemit funksional të raportimit financiar për mbikëqyrjen, Mirëmbajtja e llogarive dhe faturave, Koordinimi i shënimeve dhe menaxhimi i Arkës (Petty Cash-it) në bazë të Ligjit nr.03/L-048 Koordinimi dhe

përgatitja e të gjitha raporteve të çmimeve dhe shpenzimeve Regjistrimi i të gjitha pagesave përmes një sistemi aktual të arkivimit

2.5. DEPARTAMENTI LIGJOR DHE LICENCIM

Roli i Departamentit Ligjor/Licencim është të ofron përgatitjen e legjislacionit të transportit hekurudhor dhe politikave të ndryshme të ndërlidhura me licencimin e ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxherit të infrastrukturës. Ai gjithashtu do të përfshihet në ofrimin e mbështetjen juridike për Autoritetin dhe kompanitë. Përgatitja e rregulloreve dhe udhëzimeve sipas direktivave të BE-së, duke përfshirë legjislacionin në fuqi. Përgatitja e shkresave administrativo-juridike për gjykata si dhe përfaqësimi i ARH-se në kontestet gjyqësore. Mbështet të gjitha departamentet e ARH-së në çështje ligjore.

Departamenti ligjor/Licencim gjatë vitit 2011 ka zhvilluar një sërë aktivitete në drejtim të kompletimit të kornizës ligjore rregullative, duke përfshirë dhënien e komenteve në propozimet për ndryshimin e ligjit të hekurudhave, në zhvillimin dhe miratimin e legjislacionit të ri për hekurudhat e Kosovës. Gjatë përgatitjes së këtyre rregullave, ARH është përkujdesur që ato të jenë në pajtim me Direktivat dhe Rregulloret e BE-së, si dhe ligjet e zbatueshme në Kosovë.

Departamenti ka punuar në përgatitjen e udhëzimeve administrative dhe vendimeve të nevojshme për ARH-në. Si dhe ka ndihmuar në përgatitjen e rregulloreve dhe kriterëve për Licencim të ndërmarrjeve hekurudhore dhe menaxhereve të infrastrukturës në Republikën e Kosovës së bashku me Asistencën teknike.

2.6. DEPARTAMENTI I ÇESHTJEVE TEKNIKE DHE HULUMTIMIT TE AKSIDENTEVE

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore të këtij Departamenti për Çështje Teknike dhe Hulumtimit të të Aksidentëve janë përqendruar në ngritjen e sigurisë sa më të lartë, hetimin dhe inspektimin e aksidentëve në infrastrukturën hekurudhore të Kosovës në bazë të standardeve të caktuara në mënyrë që qarkullimi i trenave dhe mjeteve lëvizëse në hekurudhë të jetë i sigurtë dhe i besueshëm për qytetarët. Qëllimi i këtij departamenti për të hetuar një aksident ka qenë për të përmirësuar sigurinë hekurudhore dhe për të parandaluar aksidentet e mëtejshëm që ndodhin. Kjo është arritur duke identifikuar shkaqet e aksidentëve dhe aspekte të tjera që sjellin një rezultat jo të mirë. Dhënja e rekomandimeve ishte e domosdoshme dhe e rëndësishme për shmangien e incidenteve dhe aksidentëve në të ardhmen për aq sa është e mundur ose ndryshe për përmirsimin e sigurisë hekurudhore.

Departamenti i Çështjeve teknike Hulumtim të Aksidentëve monitoron detyrat e raportimit të menaxherit të infrastrukturës, aplikuesve dhe ndërmarrjeve hekurudhore dhe organeve të tjera të cilat janë të përfshira në sektorin hekurudhor. Hetimi dhe raportimi për aksidente, si dhe hartimi i procedurave të kryerjes së hetimeve për aksidente. Përcakton standardet, procedurën dhe kodin teknik, politikat dhe rregulloret për pajisjet rrokullisese.

Hetimet e aksidentëve hekurudhore nga Trupi hetues janë krejtësisht të pavarura dhe janë të përqëndruara vetëm në përmirësimin e sigurisë, duke mos bërë shpërndarje faji apo përgjegjësie por duke sjellur rezultate mbi ndodhinë e aksidentit dhe shkaktarët të cilët kanë sjellur aksidentin. Elemente të rëndësishme për hetimin e një aksidenti konsiderohet mbledhja dhe analiza e të dhënave për

aksidentet për të ndërmarr hapa në drejtim të zvogëlimit të shkaktarëve të aksidenteve në komunikacionin hekurudhor.

2.7. DEPARTAMENTI I INTEROPERABILITETIT

Departamenti Interoperabilitetit në Kosovë është për të siguruar që sektori hekurudhor përputhet dhe do të përputhet në të ardhmen me kërkesat për interoperabilitet siç janë definuar nga direktivat dhe rregulloret e BE-së, e në veçanti me rregulloren e Agjencionit Evropian Hekurudhor. Ky departament duhet të jetë i pavarur nga çdo menaxher i infrastrukturës, ndërmarrje hekurudhore, prodhues i pajisjeve të hekurudhave, ofrues i shërbimeve të mirëmbajtjes dhe nga çdo palë tjetër, interesat e së cilës do të ishin në konflikt me detyrat që i janë besuar organit për Interoperabilitet.

Organi përgjegjës për interoperabilitetin e hekurudhave duhet t'i njoh dhe t'i kontrolloj organet përgjegjëse nacionale të akredituara për themelimin e deklaratave të konformitetit apo përshtatshmërisë për përdorim dhe deklaratave për verifikimin e nënsistemeve strukturale hekurudhore dhe sistemeve si dhe të deklaratave për verifikimin e mjeteve transportuese hekurudhore, ashtu që nënsistemet hekurudhore strukturale dhe sistemet si dhe mjetet transportuese hekurudhore të mund të autorizohen që të futen në shërbim.

Departamenti për çështjet e interoperabilitetit të hekurudhave duhet të jetë përgjegjës për numërimin e mjeteve transportuese të cilat janë në shërbim në Kosovë dhe për mbajtjen e regjistrit ad hoc me të gjitha informatat e kërkuara siç janë përshkruar në ligj.

Departamenti për çështje të interoperabilitetit duhet t'i kryej detyrat në mënyrë të hapur, jo diskriminuese dhe transparente. Në veçanti, duhet t'i lejojë të gjitha palët e interesuara që të shprehen dhe duhet t'i arsyetoj vendimet e tij.

Departamenti Interoperabilitetit duhet të përgatitë raportin vjetor të cilin ia paraqet ARH-së. Ky raport i dorëzohet ARH-së, deri në fund të janarit të vitit vijues.

2.8. DEPARTAMENTI I SIGURISË

Departamenti për sigurinë hekurudhore i janë besuar të paktën detyrat në vazhdim:

Autorizimi për futjen në shërbim të nënsistemeve strukturale që e përbëjnë sistemin hekurudhor dhe të kontrollimit që ato kanë operuar dhe janë mirëmbajtur në përputhje me kërkesat esenciale; mbikëqyrja nëse përbërësit e interoperabilitetit të nënsistemeve hekurudhore janë në përputhje me kërkesat esenciale të kërkuara nga direktivat për ndëroperim; autorizimi i futjes në punë të mjeteve të reja lëvizëse apo i atyre të modifikuara substancialisht; lëshimi, përtëritja, amendamentimi dhe revokimi i pjesëve relevante të certifikatave të sigurisë dhe autorizimeve të sigurisë, si dhe kontrollimi nëse janë plotësuar kushtet dhe kërkesat e paraqitura në to, dhe se menaxheri i infrastrukturës dhe ndërmarrjet hekurudhore janë duke operuar sipas kërkesave të ligjit në Kosovë; monitorimi, promovimi, zbatimi dhe kur është e duhur bërja e propozimeve për të zhvilluar raporte të afërta pune me ministrinë dhe pjesëmarrësit e tjerë të tregut, kornizën rregullative të sigurisë duke përfshirë sistemin e rregullave nacionale të sigurisë; mbikëqyrja se a janë të regjistruara mjetet lëvizëse dhe nëse informacioni që ka të bëjë me sigurinë në

regjistrin nacional është i azhuruar; mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurohet rregullisht regjistri i pronarëve të mjeteve transportuese hekurudhore; mbikëqyrja se a mbahet dhe azhurohet rregullisht regjistri i infrastrukturës.

Departamenti për Sigurinë Hekurudhore duhet të kryej detyrat e veta në mënyrë të hapur, jo diskriminuese dhe transparente. Vendimet e Departamentit për Sigurinë Hekurudhore mund të kundërshtohen me mjete juridike dhe i nënshtrohen shqyrtimit ligjor dhe gjyqësor.

Departamenti për Sigurinë Hekurudhore duhet të bashkëpunoj me autoritetet tjera nacionale të sigurisë, veçmas me ato në kuadër të marrëveshjes së SEETO-s në mënyrë që të lehtësoj dhe koordinoj certifikatën e sigurisë për ndërmarrjet hekurudhore të cilave iu është dhënë traseja ndërkombëtare e trenit.

2.9. DEPARTAMENTI I RREGULLIMIT TE TREGUT

Detyrat e Departamentit të Rregullimit Tregut Hekurudhor janë si në vazhdim:

Sigurimi që pagesat e vendosura nga menaxheri i infrastrukturës apo organi i vendosjes së pagesës nuk janë diskriminuese.

Sigurimi që qasja në binarë, qasja në stacione, qasja në depot e operatorëve që plotësojnë kushtet e domosdoshme të jetë e drejt, transparente dhe jo diskriminuese.

Mbikëqyrja e negocimeve ndërmjet aplikuesve dhe menaxherëve të infrastructures hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët në lidhje me nivelet e pagesës për infrastrukturë. Ato negociata duhet të lejohen vetëm nëse ato kryhen nën mbikëqyrjen e Departamentit të Rregullimit Tregut Hekurudhor.

Intervenimi nëse negociatat e tilla kanë të ngjarë se do jenë në kundërshtim me kërkesat e këtij ligji.

Sigurimi se a përmban ekspozëu i rrjetit klauzola diskriminuese apo krijon kompetenca diskriminuese për menaxherët e infrastrukturës hekurudhore të shfrytëzimit të përbashkët, të cilat ata mund t'i shfrytëzojnë për t'i diskriminuar aplikantët.

Analizimi dhe monitorimi i konkurrencës dhe kualitetit të shërbimeve në tregun e shërbimeve hekurudhore dhe në tregjet e brendshme dhe të jashtme konkurruese. E gjithë kjo të bëhet me iniciativën e tij dhe me qëllim të parandalimit të diskriminimit në mesin e aplikantëve.

Departamenti i Rregullimit të Tregut Hekurudhor bënë shqyrtimin e ankesave për tregun hekurudhor, adresimin e ankesave të konsumatorëve dhe sigurimin e mbrojtjes së konsumatorëve.

Departamenti i Rregullimit të Tregut Hekurudhor nën kordinimin e ARH duhet të bashkëpunojë me organet e tjera rregullative të tregut hekurudhor veçmas sa i përket Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit ndërmjet partnerëve të SEETO-s në mënyrë që të lehtësohen dhe koordinohen kushtet rregullative të tregut hekurudhor në vendet e ndryshme.

Organogrami i ARH-se




Figura 1: Struktura organizative e ARH-së në bazë të kërkesës ligjore dhe vendimit të bordit

3. REKRUTIMI I STAFIT TE ARH-së GJATE VITIT 2011

Autoriteti Rregullativ i hekurudhave gjatë vitit 2011 ka respektuar mundësitë buxhetore dhe sipas mundësive dhe prioriteteve ka rekrutuar këto pozita:

1. Kryesus i Departamentit Ligjor dhe Licencim

Për tri pozitat e domosdoshme për plotësimin e tri departamenteve si kërkesë ligjore mbetet për vitin e ardhshëm, pasi që nuk janë lejuar pozita të reja këtë vit.

4. BUXHETI DHE SHPENZIMET E ARH-së GJATË VITIT 2011

Në kuadër të ARH-së, Divizioni i Financave ka përgatitur dhe paraqitur Pasqyrat Financiare brenda afateve ligjore, ku në to janë përfshirë shënimet për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2011 të përgatitura sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit të Sektorit Publik “Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të bazuar në para të gatshme”, që i përmbushin të gjitha obligimet raportuese që dalin nga Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë Nr. 03/L-048 dhe Ligjin Nr. 03/L-221 për ndryshim plotësimin e LMFPP ku janë të bazuara në shënimet financiare të mbajtura në mënyrë të duhur.

Kështu që ne kemi konfirmuar, për sa kemi patur njohuri dhe besim, që: Nuk ka pasur parregullësi lidhur me Udhëheqësinë apo me Punëtorët, e cila ka mundur të ketë efekt material në pasqyrat financiare.

Informatat e dhëna dhe të prezantuara në pasqyrat financiare lidhur me identifikimin e fondeve dhe shpenzimin e tyre të lidhura me Buxhetin e konsoliduar të Kosovës kanë qenë të plota dhe të sakta.

Informatat në lidhje me grumbullimin e të hyrave kanë qenë të sakta.

Nuk ka pasur llogari bankare të Buxhetit të Republikës së Kosovës përveç llogarive bankare të specifikuara në pasqyrat financiare dhe ky specifikim është i plotë dhe i saktë si në datën 31 dhjetor 2011.

Nuk ka pasur shkelje të kërkesave të Autoriteteve Rregullative të cilat kanë mundur të kenë efekt material në pasqyrat financiare, në rast se do të shkeleshin.

Nuk ka pasur ndonjë ankesë (ligjore) në proces e cila mund të ketë efekt material në pasqyrat financiare. Të gjitha detyrimet, si ato aktuale ashtu edhe në kontinuitet, dhe të gjitha garancitë që u kemi dhënë palëve të treta janë regjistruar dhe/ose shpalosur në mënyrën e duhur.

Të gjitha huat për palët e jashtme janë regjistruar dhe/ose janë shpalosur, sipas rrethanave.

Nuk ka pasur asnjë transaksion pas përfundimit të periudhës i cili do të kërkonte korrigjim ose shpalosje në pasqyrat financiare apo në shënimet e tyre.

Prandaj, Pasqyrat Financiare të konsoliduara nga Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave-ARH kanë paraqitur një prezantim të vërtetë dhe të paanshëm të Financave dhe transaksioneve financiare për vitin 2011.

Andaj për të qartësuar pozicionimin financiar të ARH-së ne do të shpalosim informatat e plota dhe të qarta të cilat do të jenë paraqitje financiare për vitin 2011 ku rrjedhshmëria e e punëve dhe shërbimeve sipas kategorive gjatë këtij viti ka qenë:

Paga dhe Meditje: Rrjedhshmëria dhe paraqitja e listë-pagave, formularëve për punëtor të rinj, rektroaktivet, formularët për ndryshime janë paraqitur qdoherë sipas afateve kohore të përcaktuara me ligj.

Mallra dhe Sherbime: Rrjedhshmëria e shpenzimeve ka qenë sipas planifikimeve dhe afateve ligjore të përcaktuara me ligj dhe të gjitha procedurat për pagesa janë zhvilluar sipas rregullave dhe kritereve të lejuara.

Shpenzime Komunale: Rritja e shpenzimeve nga kjo kategori gjatë këtij viti ka qenë në rritje ku edhe mendojmë se në vazhdimësi në vitet në vijim pasi që si Institucion i ri pretendojmë në rritje të stafit do të ketë ndikime të rritjes së shpenzimeve përmes rritjes së hapësirave të punës dhe shtimit të nevojave për shfrytëzimin e shërbimeve tjera komunale.

Subvencione: Nuk kemi pasur subvencione direkte ose grante gjatë këtij viti as nga Qeveria as nga Donatorët apo ndonje nivel tjetër.

Shpenzime kapitale: Nuk kemi patur shpenzime kjo kategori fare edhe pse nevojat për shpenzime nga kjo kategori janë të domosdoshme pikërisht shpenzime për blerje të veturave për nevoja të institucionit mirëpo mbetet obligim i periudhës së ardhshme.

Për një sqarim të përgjithshëm do të japim një gjendje të përgjithshme financiare dhe një ndarje krahasuese për të gjitha kategoritë buxhetore duke paraqitur të dhënat e vitit paraprak të cilat na jepin një pasqyrë më të mirë, më të qartë dhe më me vizion për të ardhmen e Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave

Ndarjet buxhetore në Total nga të gjitha Kategoritë Buxhetore, Varianca dhe Krahasimet.

Pasqyra e krahasimit të shumave buxhetore dhe aktuale për ARH

Për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2011

		2011		2010		2009
		Buxheti fillestar (Ndarja)	Buxheti final (Ndarja)	Realizimi	Varianca D=C-B	Realizimi
		A	B	C		F
		€	€	€	€	€
Shënime						
Hyrja e parasë së gatshme në llogari të Thesarit						
Tatimet	14					
Të hyrat vetanake	15					
Donacionet	16					
Pranimet kapitale	17					
Fondi i Privatizimit	18					
Huazimet	19					
Tjera	20					
Pranimet totale të mbledhura për FKK-në		-	-	-	-	-
Daljet e parasë së gatshme nga llogaritë e Thesarit						
Pagat dhe mëditjet	21	71,492.00	73,522.00	73,514.67	7.33	34,119.65
Mallrat dhe shërbimet	22	76,013.00	76,013.00	68,434.99	7,578.01	77,913.93
Shërbimet komunale	23	14,000.00	5,476.00	5,086.94	389.06	81.74
Transferet dhe subvencionet	24					
Shpenzimet kapitale	25					
Fondi i privatizimit	26					
Kthimi i huazimeve						
Tjerat	27					
Totali i pagesave i bërë nga BRK nëpërmes LIVTh		161,505.00	155,281.10	147,036.60	7,974.40	112,115.32
						-

Paga:Raporti në mes Buxhetit Final dhe Realizimit të buxhetit është 99.99 % (kemi shtim të mjeteve në fundvit nga niveli qendror nga kjo kategori).

Përshkrimi	2011			2010	2009
	GQ €	THV €	GPD €		
Pagesat					
Neto pagat		61,980.31	-	61,980.31	27,760.82
Pagesat për sindikata -0.10% te 0.50%					
Pagesa neto për punë jashtë orarit					
Pagesa për punë me orar të shkurtuar					
Pagesa për punë në ndërrim të natës					
Pagesa neto për pushim të lehonisë					
Mëditjet e delegatëve dhe komisioneve					
Punëtorët me kontratë					
Tatimi në të ardhura personale		4,532.80	-	4,532.80	2,497.40
Pagesa e kontributit pensional nga punëdhënësi		3,500.78	-	3,500.78	1,624.75
Pagesa e kontributit pensional nga i punësuar		3,500.78	-	3,500.78	1,624.75
Shujtat				611.93	
Gjithsej Pagesat	-	73,514.67	-	73,514.67	34,119.65

Sqarim:Gjatë viti 2011 Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave ka pasur të aprovuar dhe njëkohësisht të angazhuar 12 punonjës

Gjatë vitit 2011 Ministria e Financave në bazë të Vendimit Qeveritar Nr.04/03 ka bërë harmonizimin e buxhetit nga kategoria e pagave në fundvit

Pra :Buxheti fillestar 71,492.00 €

Harmonizimi Qeveritar 2,030.00 € (Vendimi Qeveritar Nr 04/03)

Buxheti në dispozicion gjatë vitit/Nën alokimi 73,522.00 €

Realizimi i Buxhetit gjatë vitit 73,514.67 €

Mallra dhe Shërbime: Raporti në mes Buxhetit Final ,shkurtimeve qendror qeveritar dhe Realizimit të buxhetit është 95.77 %

Përshkrimi	2011			2010	2009
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€
Pagesat					
Shpenzimet e udhëtimit	6,818.62			6,818.62	10,720.04
Shërbimet e telekomunikimit	4,080.00			4,080.00	3,715.00
Shpenzimet për shërbime	18,982.50			18,982.50	10,201.06
Mobiljet dhe pajisjet nën 1000 Euro	805.00			805.00	35,342.00
Mobiljet dhe pajisjet tjera 1000 - 5000 Euro					
Blerje tjera të mallrave dhe shërbimeve	7,182.76			7,182.76	5,320.75
Derivatet dhe lëndët djegëse	5,073.59			5,073.59	390.38
Shërbimet financiare					
Shërbimet e regjistrimit dhe sigurimeve	535.50			535.50	
Mungesa në arkë-kthimet					2,179.76
Mirëmbajtja	6,080.24			6,080.24	
Qiraja	16,250.00			16,250.00	2,491.00
Shpenzimet e marketingut	1,711.18			1,711.18	7,442.14
Shpenzimet e përfaqësimit	915.60			915.60	111.80
Vendimet e gjykatave					
Tatimi					
Servisimi i borxhit					
Gjithsej Pagesat	68,434.99	-	-	68,434.99	77,913.93

Sqarim: Gjatë vitit 2011 Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave në bazë të Vendimit Qeveritar Nr 04/26 ka patur një reduktim të fondit të alokimit prej 6% nga kategoria Mallra dhe Shërbime

Pra :Buxheti fillestar dhe final 76,013.00 €

Reduktimi Qeveritar i Alokimit 4,561.00 € (Vendimi Qeveritar Nr 04/26)

Buxheti në dispozicion gjatë vitit/Nën alokimi 71,452.00 €

Realizimi i Buxhetit gjatë vitit 68,434.99€

Shpenzime Komunale: Raporti në mes Buxhetit Final ,shkurtimit qendror qeveritar dhe Realizimit të buxhetit është 88.52 %

Përshkrimi	2011			2010	2009
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€
Rryma	2,186.10			2,186.10	81.74
Uji					
Telefon	2,900.84			2,900.84	
Gjithsej Pagesat	5,086.94	-	-	5,086.94	81.74

Sqarim: Gjatë vitit 2011 Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave në bazë të Vendimit Qeveritar Nr.22/53 ka patur një reduktim prej 8,253.90 € nga kategoria e Shpenzimeve Komunale

Pra :Buxheti fillestar 14,000.00 €

Reduktimi Qeveritar i Alokimit 8,253.90 € (Vendimi Qeveritar Nr 22/53)

Buxheti në dispozicion gjatë vitit/Nën alokimi 5,746.10 €

Realizimi i Buxhetit gjatë vitit 5,086.94 €

Të Hyrat vetanake

Përshkrimi	Shënime	2011	2010	2009	% e totalit 2011	% e ndryshimit nga 2010
		€	€	€		
Të hyrat nga taksat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga taksat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga dënimet-gjobat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga licencat 1 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga licencat 2 të ARH-së					%	%
Të hyrat nga shitja e pasurisë dhe shërbimeve					%	%
Të hyrat nga inspektimi					%	%
Të hyrat nga interesi bankar					%	%
Të hyrat nga ndryshimet e pozicionit të kursit					%	%
Tarifa për akreditim					%	%
Të hyrat nga pasuria e ARH-së					%	%
Pranimet tjera të ARH-së					%	%
Totali		0	0	0	0%	%

ARH ende nuk ka filluar inkasimin e mjeteve përmes Taksave administrative, Gjjobave, Licencave, Lejeve të Sigurisë dhe pranimet tjera si të Hyra Institucionale.

Subvencione dhe Transfere

Përshkrimi	2011				2010	2009
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Subvencionet për entitetet publike						
Subvencionet për entitetet kulturore						
Subvencionet për entitetet jo-publike						
Transfere për qeveri tjera						
Pagesat për përfituesit individualë						
Pensionet bazë						
Pensionet invalide						
Pensionet ose ndihmat sociale						
Pensionet e TMK-së						
Pensionet e kategorisë I (anëtarët e familjes)						
Pensionet e kategorisë II (anëtarët e familjes)						
Pagesat për invalidët e luftës						
Pagesat për invalidët civilë						
Pagesat për familjet e viktimave të luftës						
Pensionet e përkohshme të Trepçës						
Vendimet gjyqësore						
Gjithsej Pagesat	-	-	-	-	-	-

ARH gjatë vitit 2011 nuk ka pasur ndonjë Subvencionim apo transfer Qeveritar.

Shpenzimet Kapitale

Përshkrimi	2011				2010	2009
	GQ €	THV €	GPD €	Totali €	€	€
Pagesat						
Ndërtesat					-	-
Ndërtimi i rrugëve					-	-
Kanalizimi					-	-
Ujësjellësi					-	-
Energjia, gjenerimi, bartja dhe furnizimi					-	-
Pajisje mbi 1000 Euro					-	-
Automjete transporti						
Makineria						
Kapitalet tjera					-	-
Toka						
Pasuritë e paprekshme						
Transferet kapitale për entitetet publike						
Transferet kapitale për entitetet jopublike						
Vendimet gjyqësore						
Gjithsej Pagesat	-	-	-	-	-	-

ARH gjatë vitit 2011 nuk ka pasur mbështetjen nga niveli qendror për projekte kapitale ku si nevoja janë identifikuar me kohë dhe kemi paraqitur projektet për këtë kategori mirëpo nuk kemi pasur aprovime buxhetore për këtë kategori.

5. PROKURIMI

Në mungesë të stafit apo numrit të lejuar nga MF, ARH nuk ka pasur zyrtar të rekrutuar të prokurimit, për kryerjen e shërbimeve të prokurimit ka qenë e obliguar që të kërkoj nga institucionet tjera perkrahje për zhvillim të procedurave por këtë nuk e ka gjetur pa kompensim.

Tirulli i aktivitetit të prokurimit	Data e nënshkrimit të kontratës	Çmimi i kontratës	Data e publikimit të tenderit	Data e mbyllje së tenderit	Emri i OE që i është dhënë kontata
Furnizim me kompjuter	07/07/2011	820.00	07.06.2011	13.06.2011	Comtrade
Furnizim me UPS-retender	07/07/2011	28.00	07.06.2011	13.06.2012	Pc Comp
Furnizim me Inventar	24/05/2011	805.00	12.05.2011	18.05.2011	Palma
Kurse të gj. Angleze	10/11/2011	994.00	28.09.2011	06.10.2011	Language Academy
Dreka zyrtare	15/04/2011	431.00	08.04.2011	08.06.2011	Vila Piknik
Mirëmbajtja dhe pastrimi i objektit të ARH-së	22/12/2011	2,490.00	15.12.2011	20.12.2011	N.P.SH ESG
Furnizim me ujë	24/05/2011	35.00	20.05.2011	20.05.2011	Kelmendi&Partners
Servisimi i Klimave	14/12/2011	340.00	14.12.2011	14.12.2011	Leoni Inzhinjering
Furnizim me dhurata të vitit të ri	19/12/2011	198.00	19.12.2011	19.12.2011	N.T.P Koliqi
Sigurimi fizik i Objektit	30/12/2011	535.50	30.12.2011	30.12.2011	SFK Security-PZ
TOTALI	6,676.50 €				

6. PERKRAHJA PER ZBATIMIN E MARREVESHJES SE KOMUNITETIT TE TRANSPORTIT(EU TCA)

Përkrahja për zbatimin e Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit (EU TCA) është projekt i financuar nga Unioni Evropian dhe i menaxhuar nga Zyra Ndërlidhëse e Unionit Evropian dhe e implementuar nga kompania Egis-BCEOM nga Franca, perfitues kryesor janë Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave(ARH) Ministria e Infrastruktures dhe Hekurudhat e Kosoves .

Projekti për “Përkrahjen në zbatimin e marrëveshjes së komunitetit të transportit EU-TCA” filloi me 4 maj 2010 për 24 muaj.

Objektiva e përgjithshme e projektit është të përkrahet zbatimi i reformave në sektorin e transportit në përputshmëri me acquis-në e BE, politikat dhe praktikat, dhe që të ngriten kapacitetet institucionale për zbatimin e këtyre reformave.

6.1. Marrëveshja ndërkufitare me Maqedoninë

Qeveria e Republikës së Kosovës me qëllim të krijimit të Marrëveshjes Kornizë me të cilën përcaktohen parimet mbi qasjen e hapur në kalimin kufitar ndërmjet tyre, pra Organizimin e komunikacionit hekurudhor kufitar ka përfunduar Marrëveshjen e Organizimit të komunikacionit Hekurudhor Kufitar me qëllim të rritjes së konkurrencës për shërbimet hekurudhore, pra e cila do të jetë si bazë për strukturën dhe përmbajtjen e të gjitha marrëveshjeve shtesë bilaterale ndërmjet autoriteteve përkatëse të palëve kontraktuese.

6.2. Asistenca Teknike për ARH-në

Projekti i asistencës teknike “për ngritje të kapaciteteve të ARH-së”, i financuar nga zyra ndërlidhëse e Komisionit Evropian ZNKE dhe implementuar nga kompania konsulente ndërkombëtare “Egis International”, ka filluar në vitin 2010 dhe ka vazhduar edhe gjatë vitit 2011. Qëllimi kryesor i projektit ka qenë që në mënyrë efikase, të ndihmoj në përgatitjen e kornizës ligjore dhe të sigurojë kushte transparente dhe jodiskriminuese për kriteret dhe procedurat për dhënien e Licencave për Ndërmarrjet Hekurudhore dhe Menaxherit të Infrastrukturës në sektorin e transportit Hekurudhor në Kosovë, në pajtueshmëri të plotë me Ligjin e Hekurudhave të Republikës së Kosovës dhe duke u bazuar në Direktivat e Bashkimit Evropian.

Në kuader të këtij projekti ka qenë i parapare edhe një ekspert në cilesinë e Konsulences në ARH, në bashkpunim me ekspertin e angazhuar janë hartuar disa nga draft-rregulloret në kuader të kornizës ligjore në Kosovë për sektorin hekurudhor dhe duke respektuar direktivat e BE-se, ARH nuk ka mundur të perfitoj sa duhet nga ky ekspert pasi që ka pasur mungesë në staf të tri departamenteve kyqje të ARH-se. Në kuadër të këtij projekti, në vitin 2011 ARH-ja ka bërë dy vizita studimore në Francë dhe Holandë të përfaqësuar nga Kryesuesi i Bordit në Francë dhe Drejtori i Përgjithshëm në Holandë, për Strategjinë e Transportit Multimodal STMM, për të parë nga afër organizimin në mes të institucioneve mbikeqyrese dhe kompanive që operojnë atje në këtë sektor.

6.3. IPA Projekti

Me kërkesë të vazhdueshme për buxhet ARH ka perfituar nga Komisioni Evropian perkatesisht nga ZNKE në Prishtinë një kontratë kalimtare për vitin 2012 në vlerë prej 200 mijë euro si dhe mbështetjen tjetër nga IPA për vitin 2013-2014 ku kusht është vetëm buxheti i mjaftueshëm për rekrutimin e stafit teknik të ARH-së. Projekti ka vlerë 1 milion euro dhe financohet nga BE-ja si pjesë e Instrumentit të Paraanëtarësimit (IPA) me qëllim të përafrimit të legjislacionit tonë me atë të BE-së dhe trajnimin e personelit; me një fjalë, ngritjen e kapaciteteve të autoritetit rregullativ të Hekurudhave të Republikës së Kosovës në një nivel të njëjtë me ato të vendeve anëtare të BE-së. Projekti do të zgjasë dy vjet.

7. Gjendja aktuale dhe zhvillimet e ardhshme të Hekurudhave të Kosovës

Vija e parë hekurudhore në Kosovë është ndërtuar në vitin 1874 në relacionin Hani i Elezit – Fushë Kosovë – Mitrovicë. Më vonë ka filluar dhe është kryer ndërtimi i rrjetit ekzistues hekurudhor nëpër tërë territorin e Kosovës. Hekurudhat e Kosovës shtrihen në tërë territorin e Kosovës me një gjatësi prej 333,451 km. Në këtë gjatësi nuk përfshihen vijat industriale të cilat kapin gjatësinë prej 103,4 km. Vijat hekurudhore bëjnë lidhjen e të gjitha qendrave më të rëndësishme të Kosovës përveç Gjakovës dhe Gjilanit. Vijat e hekurudhave të Kosovës kanë lidhje të drejtpërdrejt edhe me shtetet fqinje si me Maqedoninë e Serbinë dhe përmes tyre edhe me shtetet e tjera. Hekurudhat e Kosovës gjenden në një situatë mjaft të vështirë. Infrastruktura hekurudhore (binarët, ndërtesat e stacioneve, stabilimentet sinjalizuese, telekomunikuese dhe të energjetikës), pastaj operimet hekurudhore (lokomotivat, vagonët e udhëtarëve dhe ata të mallrave, punëtoritë, etj.); kërkojnë investime të mëdha, angazhim maksimal të të gjithë punonjësve, stafit menaxhues dhe autoriteteve tjera përgjegjëse, në mënyrë që të përmirësohet situata ekzistuese.

Hekurudhat e Kosovës kryesisht ndahen në dy linja

Linja Veri – Jug që përshkon vendin nga kufiri me Serbinë (Stacioni Leshak) deri në kufirin me Maqedoninë (Stacioni Hani i Elezit), me gjithsejtë 148 km në linjën bazike hekurudhore 10 të SEETO-s. Aktualisht është e vetmja linjë hekurudhore që funksionon për transportin e mallrave.

Linja Verilindje deri në Perëndim që përbëhet nga tri degë:

Linja Lindore nga kufiri me Serbinë (Stacioni Podujevë) deri në Fushë Kosovë me gjithsejtë 45 km gjatësi.

Linja Perëndimore nga Fushë Kosova deri në Pejë me gjithsejtë 81 km gjatësi.

Linja Jug-Perëndim nga Klina deri në Prizren me gjithsejtë 58 km gjatësi.

Resurset e kufizuara aktualisht janë të drejtuara kryesisht në mirëmbajtjen dhe investimin në rrjetin hekurudhor. Natyrisht, me hapjen e rrjetave rajonale strategjike ose zhvillimin e industrive të reja

nxjerrëse dhe nevojën për bartjen e mallrave të renda , pritet të rritet nevoja për investim në infrastrukturës hekurudhore.

Transporti i udhëtarëve:

Hekurudhat e Kosovës (HK), po ashtu ofrojnë shërbimin e transportit të udhëtarëve brenda dhe jashtë Kosovës.

Transporti i brendshëm

Për transport të brendshëm HK-të i kanë këta trena të rregullt ditor:

- ✓ Treni i Shpejt (IC) – i cili qarkullon çdo ditë në relacionin Pejë – Prishtinë – Pejë.
- ✓ Treni Lokal (TL)– i cili qarkullon çdo ditë në relacionin Pejë – Prishtinë – Pejë
- ✓ Treni i Lëvizjes së Lirë (TLL) - në relacionin Hani i Elezit - Fushë Kosovë

Fushë Kosovë – Graçanicë – Fushë Kosovë , momentalisht kjo linjë nuk funksionon.

Transporti ndërkombëtar

Për transport ndërkombëtarë HK kanë një tren të rregullt të ashtuquajtur Treni i Shpejtë (IC) i cili qarkullon një herë në ditë në relacionin Prishtinë – Shkup – Prishtinë.

Edhe transporti i mallrave është mire i organizuar si transport konvencional, te kombinuar dhe me kontejner.

7.1. NDARJA E HEKURUDHAVE TE KOSOVES

Bazuar në vendimin e Qeverisë të Republikës së Kosovës nr. 05/110 të datës 26.02.2010 mbi ndarjen e Hekurudhave të Kosovës ShA, Ministri i Ekonomisë dhe Financave me vendimin nr. 718 të datës 03.06.2010 ka themeluar Grupin punues mbi Implementimin e Vendimit të Qeverise nr. 05/110, i cili grup punues është plotësuar edhe sipas Vendimit të Ministrit të MZHE nr. 1378 të datës 17.08.2011 . Ne kete grup punues ne cilesine e vëzhguesit është emeruar edhe Kryesuesi i Bordit të ARH-së z. Halit Gara Detyrë e grupit punues ka qenë të mbikëqyrë punën e nëngrupeve punuese që do të bëjnë ndarjen e aseteve, financave dhe stafit në dy kompani të reja dhe atë: në INFRAKOS dhe TRAINKOS si dhe të hartoi materialet tjera rreth ndarjes së HK siç ishin:

Statutin e kompanisë-Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës-INFRAKOS

Statutin e kompanisë-Operimet me trena i Hekurudhave të Kosovës-TRAINKOS,

Dokumentacionin tjetër për shthurjen dhe regjistrimin e dy kompanive të reja;

Marrëveshjen përmes së cilës MZHE e bën transferimin e aseteve të Infrastrukturës së Hekurudhave në INFRAKOS,Sh.A

Marrëveshjen përmes së cilës MZHE e bën transferimin e aseteve të operimit me trena tek TRAINKOS,Sh.A;

Marrëveshjen përmes së cilës përcaktohet Subvencionimi i transportit të lirë të udhëtarëve, e lidhur mes MI dhe TrainKos-it;

Marrëveshjen MZHE - INFRAKOS mbi financimin e infrastrukturës hekurudhore dhe dokumente tjera të nevojshme.

Grupi punues përpiloi planin e punës dhe përcaktoj detyrat në mënyrë që ndarja e Hekurudhave të Kosovës të kryhet në mënyrë të suksesshme dhe kërkoj nga Hekurudhat e Kosovës që të formohen edhe nëngrupet punuese teknike të cilat kishin për detyrë të lehtësonin punën e Grupit Punues:

- i. Grupi punues mbi ndarjen e aseteve;
- ii. Grupi punues mbi ndarjen e stafit;
- iii. Grupi punues mbi ndarjen financiare; dhe
- iv. Nēngrupi punues mbi pagesat;
- v. Nēngrupi punues mbi kontestet gjyqësore.

Grupi Punues dhe të gjitha nëngrupet punuese teknike me ndihmën e konsulentëve të jashtëm kanë punuar në realizimin e detyrave të parapara dhe të përcaktuara me planin e punës për ndarjen e kompanisë.

Me planin e punës mbi ndarjen e HK-së janë paraparë dhe janë përpiluar një numër i konsideruar i dokumenteve të cilat janë të domosdoshme për funksionimin e dy kompanive të reja.

Për sqarim më të hollësishëm, në vijim janë prezantuar veprimet dhe dokumentet të cilat i ka kryer Grupi Punues dhe nëngrupet teknike për ndarjen e Hekurudhave të Kosovës ShA:

- a) Statuti i INFRAKOS
- b) Statuti i TRAINKOS
- c) Marrëveshja MZHE – INFRAKOS mbi financimin e infrastrukturës hekurudhore
- d) Marrëveshja MI- TRAINKOS mbi Obligimet e Shërbimeve Publike (OSHP)
- e) Marrëveshja mbi Transferimin e aseteve MZHE – INFRAKOS-i
- f) Marrëveshja mbi Transferimin e aseteve MZHE – TRAINKOS-i
- g) Raportin mbi ndarjen e financave
- h) Raportin mbi ndarjen e aseteve dhe
- i) Raportin mbi ndarjen e stafit.

Grupet punuese teknike kanë filluar punën dhe kanë punuar në mënyrë intensive, puna e të cilëve është shqyrtuar disa herë nga grupi punues qendror dhe është sugjeruar për plotësime ndërsa përfundimisht është miratuar nga grupi punues qendror me 09 dhjetor 2011.

Po ashtu edhe me hartimin e dokumenteve për regjistrimin e kompanive të reja (Statutet), është punuar suksesshëm dhe menjëherë pas emërimit të Bordeve të përkohshme të dy kompanive, të njëjtat janë miratuar nga Bordet e kompanive.

Me datën 20.07.2011, Qeveria e Kosovës ka sjell vendimin për emërimin e Bordit ekzistues të Drejtorëve si Bord të INFRAKOS-it dhe njëkohësisht e ka emëruar edhe Bordin e Drejtorëve të TRAINKOS-it. Emërimi i Bordit të Drejtorëve të INFRAKOS-it është bërë me datën 15.08.2011 me ç

‘rast është miratuar statuti i kompanisë, ndërsa konstituimi i Bordit të Drejtorëve të TRAINKOS-it është bërë me datën 16.08.2011 me ç ‘rast po ashtu është miratuar statuti i kompanisë.

Me datën 18.08.2011 është bërë aplikimi për regjistrim i të dy kompanive në Agjencinë Kosovare për Regjistrimin e Bizneseve ndërsa me datën 23.08.2011 janë pranuar certifikatat e regjistrimit.

Vlen të theksohet që grupi punues është njoftuar se sipas sugjerimeve të AKRB-së-MTI INFRAKOS-i do të jetë si kompani trashëguese e NRB të HK-së ndërsa emri i saj është po ai i Riu sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës-INFRAKOS,Sh.A, ndërsa TRAINKOS-i të regjistrohet si kompani me NRB të ri.

Kjo është bërë për shkak të procedurave tejet të komplikuara të çregjistrimit të kompanisë ekzistuese dhe për shkak të lehtësive të zgjidhjes së problemeve ekzistuese kontraktuale, borxheve dhe detyrimeve tjera. Mirëpo, gjatë procesit të ndarjes është trajtuar secili element (duke filluar nga borxhet, obligimet, detyrimet e deri te kontestet gjyqësore) në mënyrë që secila prej kompanive të reja të trashëgon atë që i takon. Zyrtarisht tani kemi dy kompani publike.

- Infrastrukturën e Hekurudhave të Kosovës ShA (INFRAKOS); dhe
- Operimin me Trena të Hekurudhave të Kosovës ShA (TRAINKOS).

8. AKTIVITET E ARH-se

Gjatë vitit 2011 Bordi Drejtues i ARH-së ka mbajtur dhjetë 10 takime të rregullta të bordit dhe po ashtu ka vazhduar në ndertimin e raporteve institucionale përmes takimeve të shumta dhe shkresave brenda dhe jashtë vendit po ashtu ka përkrahur menaxhmentin në konsolidimin dhe organizimin e institucionit.

8.1. Licensimi dhe Legjislacioni

ARH gjatë vitit 2011 ka dhënë kontribut të rëndësishëm në grupet e ndryshme punuese në hartimin e ligjit të ri për hekurudhat.

Me 24 dhe 25 mars 2011 është mbajtur takimi i Dialogut për Procesin e Stabilizim Asocimit (DPSA) në Prishtinë Bordi i ARH-se ka marrur pjesë në këtë takim dhe nga ky takim kanë rezultuar edhe veprimet përcjellëse pra që ARH-në ta bëjmë operative me staf të nevojshëm duke forcuar shërbimet e licencimit, sigurisë së hekurudhave në kuadër të ARH-se, legjislacioni shoqëruar, si dhe për hapat e funksionalizimit të trupit për hetimin e aksidenteve hekurudhore të ndara nga ARH. Kryesuesi i Bordit ka mbajtur edhe një prezentim për gjendjen dhe zhvillimin e ARH-së.

Duke qenë të informuar se është duke u punuar në draft ligjin për Hekurudhat nga ky takim ka rezultuar edhe një kërkesë që do të përciellet në periudhat e mëvonshme: Forcimi dhe mbajtja e funksioneve kryesore të ARH-së që sigurojnë qëndrueshmërinë financiare përmes taksës për certifikatë të sigurisë dhe vënies se gjobave për operatorët të cilët nuk veprojnë në përputhje me rregullat në fuqi.

Autoriteti Rregullativ i Hekurudhave (ARH) ka filluar procesin e ristrukturimit në bazë të ligjit të ri për hekurudhat nr.04/L-063 i cili është aprovuar nga Parlamenti i Republikës së Kosovës me datën 14.11.2011 dhe ka hyrë në fuqi në muajin dhjetor 2011 pas publikimit në gazetën zyrtare.

8.1.1. Aktet nënligjore

Bordi Drejtues i ARH-së përveç mbikëqyrjes së institucionit ka adaptuar këto udhëzime administrative:

1. Udhëzimi Administrativ për mbushje telefonike si dhe telefoni fikse ekziston Udhëzimi Administrativ Nr. 04/2008 për Përdorimin e Telefonave (Fiks dhe Mobil) nxjerrur nga Zyra e Kryeministrit.
2. Udhëzimi për meditje për udhëtime zyrtare: Vendimi i Ministrisë së Financave Nr. 2213/1 për tarifatat për udhëtime jashtë vendit.
3. Udhëzimi për kompenzimit e shpenzimit të studimeve: Pas konsultimit edhe me Zyren e Kryeministrit, (Zyrë për Ndihmë dhe Shërbime Juridike) është thënë se një gjë e tillë nuk është e rregulluar në nivel qeveritar, por zakonisht Institucionet e ndryshme kanë rregullat e tyre të brendshme lidhur me këtë çështje.
4. Udhëzimi për avancimin e stafit brenda ARH-së, Ligji për Shërbyesit Civilë Nr.03/L-149
5. Qarkullimi i dokumentave dhe ruajtja e tyre, bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.3/2006 i nxjerrë nga Qeveria e Republikës së Kosovës.
6. Udhëzimi për shfrytëzim të veturave, bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr.07/2006 i nxjerrë nga ana e Qeverisë
7. Orari i punës dhe ardhja në punë, sipas Ligjit të shërbimit Civil 03/L-149
8. Puna jashtë orarit, e rregulluar sipas Ligjit të shërbimit Civil, respektivisht Ligjit për pagat e shërbyesve civil 03/L-147
9. Procedurat e kryerjes së një shpenzimi (inicimi, zotimi, prokurimi, shpenzimi).

Bordi i ARH-së ka miratuar këto rregullore:

- a) Rregullore për Licencim;
- b) Kriteret dhe procedurat për dhënien e Licencave;
- c) Formulari i aplikimit për Licencë;
- d) Formularin për raportim të Aksidentëve;
- e) Licenca për kryerjen e shërbimeve të transportit hekurudhor;
- i) Udhëzimi administrativ për rregullat dhe procedurat për shqyrtimin e ankesave.

Po ashtu ka draftuar këto rregullore:

1. Rregullorja për procedurat për pranimin dhe perpunimin e aplikacioneve për Licenca

2. Rregullorja për procedurat për hetimin e një aksidenti dhe incidenti
3. Rregullorja për inspektim, hetim dhe raportim të aksidenteve
4. Licenca për ngases të Trenit
5. Taksat administrative për aplikacion dhe mirëmbajtje të licencave dhe lejeve
6. Rregullorja për inspektimin dhe monitorimin e Sigurisë në sektorin Hekurudhor
7. Draft rregullorja për certifikimit të sigurisë për aplikuesit e operatorit hekurudhor
8. Draft rregullorja për leje për aplikuesin menaxherin e infrastrukturës hekurudhore
9. Draft udhëzimi për interoperabilitet
10. Draft Aplikacioni për certifikatë të sigurisë
11. Draft autorizimi i sigurisë
12. Draft certifikata e sigurisë pjesa A
13. Draft certifikata e sigurisë pjesa B

8.1.2. Direktivat e Komisionit Evropian

ARH gjatë aktivitetit të vet në rregullimin e infrastrukurës ligjore përmes akteve nenligjore ka qenë e obliguar që në vazhdimësi bashkë me konsulentin të respektoj dhe të konsultohet edhe me direktivat e Komisionit Evropian si në vijim:

- a) Direktiva e BE-së për Licencim 91/440 dhe 95/18
- b) Direktiva e BE-së për Siguri 2004/49
- c) Direktiva e BE-së për Rregullim Tregu 2001/14 dhe 2001-475
- d) Direktiva e BE-së për Interoperabilitet 2004/49 dhe 2008/57

8.2. ARH NE FUNKSION TE SIGURISË NE SEKTORIN HEKURUDHOR

Kompania Hekurudhat e Kosovës ka perfunduar procesin të ndarjes në dy kompani në infrastrukturë dhe operime, (Infrakos dhe Trainkos) ky akt i ndarjes nënkupton edhe rritjen e përgjegjësisë së ARH-së në siguri dhe monitorim të hekurudhave.

Nisur nga kjo bazë ARH ka kryer monitorim të kompanisë dhe vizita në teren përgjat linjes hekurudhore, detajet e ketyre aktiviteteve i keni në vazhdim:

8.2.1. Inspektimet ne teren

Gjate vitit 2011 jane realizuar edhe inspektime ne teren pergjate linjave hekurudhore ku inspektimi eshte bere nga brenda lokomotivave dhe ne vendkalime e stacione ne gjithe Kosoven.

Te metat dhe rreziqet e linjës hekurudhore Prishtinë-Pejë. Ku ndër tjera janë paraqitur këto shqetësime: mungesa e ndihmës-makinistve që të asistoj në rast të paraqitjes së nevojës, veçanërisht në rast të ndonjë problemi shëndetësor të makinistit. Në rast se një gjë e tillë ndodh, nuk ka kush të marrë nën kontroll Trenin përkatës,

Ndërtimi i shtëpive apo banimeve kolektive afër hekurudhave, ka bërë që të ketë kalime ilegale mbi binarë të trenit pa mbrojtje dhe pa shenja sinjalizuese. Kjo situatë paraqet problem dhe rrezik si për makinistin dhe sistemin hekurudhor, po ashtu edhe për qytetarët. Si pasojë e kësaj, kohëzgjatja e udhëtimit të Trenit Prishtinë-Pejë dhe anasjelltas merr dyfishin e kohës së paraparë, sepse shpejtësia e lëvizjes së Trenit është e detyrueshme të jetë më e ngadaltë se sa ajo normale. Për çka udhëtimi është i mundimshëm për pasagjerët dhe si pasojë shfrytëzimi i linjës hekurudhore nga ana e qytetarëve nuk është në nivelin e dëshiruar.

Gjithashtu, gjatë këtij inspektimi është bërë kontrolli i sistemit të ndaljes dhe lajmërimeve për ndalje nga ana e makinistit dhe organet përgjegjëse të Hekurudhave nëpër stacionet në të cilat është e paraparë që Treni të ndalet.





Inspektim në relacionin e linjës hekurudhore Fushë Kosovë – Hani i Elezit- Fushë Kosovë me gjatësi prej $65 + 65 = 130$ Km.

Mirëmbajtja e infrastrukturës (trasesë dhe binareve ishte relativisht e mirë, mbushja me zhavorr rreth trasesë se binareve ishte e mirëmbajtur mirë, pastaj prej linjës Kaçanik – Hani i Elezit urat ishin të riparuar dhe të forcuara me konstruksion të çelikut.

Tunelet gjatë linjës Kaçanik – Hani i Elezit ishin në një gjendje tepër të vështir (dëmtimi trasesë dhe binareve, muret anash të dëmtuar nga vagonët e mallrave për shkak të diametrit të ngushtë të tunelit), prandaj në këto tunele duhet te merren veprimet e menjëhershme për riparimin e këtyre tuneleve sa ma shpejt. Deri sa nuk ka ndodhur ndonjë fatkeqësi me përmasa të mëdha.

Vendkalimet e shumta ilegale mbi binarë pa shenja sinjalizuese gjatë kësaj linje si dhe ndërtimi i shtëpive apo banimeve kolektive afër hekurudhave është shqetësuese. Kjo situatë paraqet problem dhe rrezik si për makinistin dhe infrastrukturën hekurudhore, po ashtu edhe për qytetarët. Në këtë linje janë 45vendkalime.

Kohëzgjatja e udhëtimit të Trenit Fushë Kosovë – Hani i Elezit zgjati 1 ore e 40 minuta po ashtu edhe anasjelltas Hani Elezit – Fushë Kosovë zgjati 1 ore e 30 minuta.

Shpejtësia e lëvizjes së Trenit ishte 60 deri 70 km/h, përveç ne tunele shpejtësia ishte e detyrueshme të jetë më e ngadaltë se sa ajo normale për shkak gjendjes tepër të vështirë të tuneleve.

Gjithashtu, gjatë kësaj vizite është bërë kontrolli i sistemit të ndaljes dhe lajmërimeve për ndalje nga ana e zyrtareve të stacionit hekurudhore të Hanit Elezit.

Vazhdimi i udhëtimit për udhëtar në linjën Hani i Elezit – Shkup, behet në stacionin Hani i Elezit, ku udhëtarët zbresin nga lokomotiva e Hekurudhave të Kosovës, pastaj hipin në lokomotivën e Maqedonisë dhe vazhdojnë udhëtimin për linjën e Shkupit.



Inspektimi i tunelit hekurudhor Kaçanik në bashkëpunim me Kompaninë Infrakos, ku është realizuar inspektimi i punimeve të tunelit hekurudhor në linjën veri – jug, Kaçanik.

Për shkak të sigurisë së komunikacionit dhe për faktin se tuneli është i vjetër rreth 130 vjeçar është vlerësuar që të punohet në këtë tunel, i cili që nga viti 1984 është parapare që të behet rekonstruimi dhe sanimi i tij. Me këtë projekt në të njëjtën kohë bëhet zgjerimi i profilit të tunelit për elektrifikim dhe sanimi i tij.

Gjatë realizimit të punimeve kompania ka has në vështirësi dhe pune të paparashikueshme siç ka qenë rrëshqitjet materialit të paqëndrueshme. E krejt kjo ka ndodhe për shkak përbërjes gjeologjike të masivit prapa mureve të tunelit dhe ndryshimeve që ka pësuar masivi i kodrës gjatë viteve.

Gjatësia e tunelit është 198.70 m, deri me tani janë punuar rreth 35 m, mirëpo ka mbetur shumë pune për të përfunduar.

Lartësia e tunelit ka qenë rreth 500 cm ndërsa kjo lartësi është rritur (zgjeruar) deri në kuotën 585 cm që i plotëson standardet për elektrifikimin e mundshëm në të ardhmen të kësaj linje.

Gjatë kësaj kohe që kanë filluar punimet e sanimit të këtij tuneli, orari i trenave në këtë linje është si me par, mirëpo vetëm Fushë – Kosovë – Kaçanik, ku në Kaçanik udhëtarëve i'u është siguruar transporti me autobus nga Kompania punëkryese deri në Han të Elezit dhe anasjelltas.

Ndërsa transporti i mallit ne këtë linje Fushë – Kosovë – Hani Elezit – Shkup organizohet natën mirëpo ka raste edhe kur ka transport të kontingjentit ushtarak të organizohet edhe ditën. Këtë organizim të transportit e bëjnë Infrakosi dhe Trainkosi të dyja se bashku.

Më poshtë janë disa fotografi të bëra gjatë vizitës të bëra punimeve në tunel:



Aktualisht Infrastruktura merret me mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e linjave hekurudhore, urave, tuneleve, ndërtesave të stacioneve, stabilimenteve sinjalo siguruese, stabilimenteve të telekomunikacionit, stabilimenteve të energjetikës, si dhe me patundshmërinë e Hekurudhave.


Detyra kryesore me të cilën merret sektori SS,TK dhe EN është mirëmbajtja e sistemeve të cilat ndihmojnë personelin ekzekutiv në kryerjen e detyrave në rregullim dhe siguri të komunikacionit hekurudhor. Në këtë sektor ka disa sisteme për rregullim të komunikacionit hekurudhor duke i përfshi pajisjet që e mundësojnë këtë funksionalizim të sistemeve. Për një mirëmbajtje dhe kontroll ma të mirë të këtyre sistemeve pajisjet janë të grupuara në tri shërbime. Secili shërbim kryen detyrat përkatëse dhe si rezultat i kësaj sistemet funksionojnë si tërësi duke i përfshi pajisjet sinjal-siguruese ato për telekomunikim dhe furnizimi i tyre me energji elektrike.

Me qëllim që ta kemi një pasqyrë ma të mirë për pajisjet nëpër shërbime dhe gjendjen e tyre funksionale në vazhdim po prezentojm gjendjen sipas shërbimeve.

Gjendja e pajisjeve sinjal-siguruese nëpër stacione

Në vijën hekurudhore Leshak- Hani i Elezit janë gjithsejtë 18 stacione hekurudhore prej të cilave 14 stacione janë të siguruara me paisje SS (Leshak, Leposaviq, Sllatin, Zveqan, Mitrovicë, Vushtrri, Prelluzhë, Kastriot, Lypjan, Bablak, Ferizaj, Gurëz, Kaçanik dhe Hani i Elezit).

Shenjat sinjalizuese nëpër vendet zyrtare (stacionet) ku janë pajisjet sinjal-siguruese të centralizuara në mënyrë automatike (sistemi “Ericsson-Energoinvest”) jepen sipas RR-1 me drita ndriçuese si ditën ashtu edhe natën. Udhëzimi i përdorimit të pultit lokal për manipulim me pajisje është nëpër secilin stacion që është i siguruar me këto pajisje.



Lista e stacioneve dhe mënyra e sigurimit të tyre:

Nr.	STACIONET	Mënyra e sigurimit dhe manipulimi me pajisje	Vërejtje
1.	Leshak	automatik	Nuk ka qasje që nga viti 2008
2.	Leposaviq	automatik	Nuk ka qasje që nga viti 2008
3.	Sllatina	automatik	Nuk ka qasje që nga viti 2008
4.	Banjska	i pa siguruar, pa personel, sistemi SS ekziston	Nuk ka qasje që nga viti 2008
5.	Zveqani me Vallaq	automatik	Nuk ka qasje që nga viti 2008
6.	Mitrovica	automatik	Vetëm ndërrueset brenda sinjaleve hyrëse mund të përdoren nga pulti, sinjalet dalëse kanë vetëm ndriçim, brezat izolues kanë kontroll vetëm brenda ndërrueseve N-1 dhe N-19. Ka probleme me kabllot të sinjalet hyrëse dhe izolimet dhe për këtë nuk mund të formohen rrugëudhimet.
7.	Vushtrria	automatik	punon
8.	Samodrexha	i pa siguruar, pa personel, nuk ka sistem SS edhe pse ka qenë para lufte	Ndërrueset janë të bllokuara për drejtim
9.	Prelluzhë	automatik	punon
10.	Obiliq	automatik	punon
11.	Lypian	automatik	punon

12.	Babllak	automatik	punon
13.	Ferizaj	automatik	punon
14.	Gurëza	automatik	punon
15.	Kaqanik	automatik	punon
16.	Hani i Elezit	automatik	punon

Stacioni i udhëtarëve në Fushë Kosovë

Sinjalet hyrëse janë të ndriçuara por nuk janë në varshmëri me ndërruese. Ndërrueset përdoren në mënyrë manuale dhe janë të siguruara me brava. Ditëve të fundit është bërë konservimi i bravave si preventive mbrojtëse për sezonin dimëror.

Stacioni i mallrave në Miradi

Nuk ka sinjale hyrëse dhe dalëse, manipulimi me ndërruese bëhet në mënyrë manuale. Ndërrueset janë të siguruara me brava dhe me to manipulon personeli i stacionit. Ditëve të fundit është bërë konservimi i bravave si preventive mbrojtëse për sezonin dimëror.

Vija Fushë-Kosovë-Pejë, Klinë-Prizren dhe Fushë Kosovë-Besianë

Pajisjet sinjal-siguruese përgjatë këtyre vijave hekurudhore gjatë luftës janë dëmtuar dhe janë të pa shfrytëzueshme për përdorim. Ndërrueset janë të siguruara me brava dhe nëpër disa stacione nuk ka as personel dhe dëmtimi i bravave vërehet vetëm kur iu bëhet kontroll e rregullt e ndërrueseve apo sipas kërkesës.

Gjendja e vendkalimeve automatike

Në vijë hekurudhore Hani i Elezit-Leshak janë të instaluar 20 vendkalime prej të cilave 19 janë automatike dhe një manuale për mbrojtjen e vendkalimeve të cilët janë në gjendje funksionale. Tri prej tyre janë jashtë funksioni (VK-Vallaq,VK-2 në Mitrovicë dhe VK-2 në Vushtri).


Nr.	Km	Shënimi	Lokacioni	Mënyra e sigurimit
Vendkalimet në vijën hekurudhore Hani i Elezit-Leshak (sistemi elektro-rele-ERICSSON)				
1.	168+270	VK1	Leshak	Automatik me bariera
2.	183+225	VK1	Leposaviq	Automatik me bariera

3.	208+604	VK1	Vallaq	Automatik me bariera
4.	210+078	VK2	Zveqan	Automatik me bariera
5.	211+481	VK3	Zveqan	Automatik me bariera
6.	214+783	VK1	Mitrovica	Automatik me bariera
7.	216+296	VK2	Mitrovica	Automatik me sinjale-nuk punon deri në lajmrin
8.	224+230	VK1	Vushtrri	Automatik me bariera
9.	225+711	VK2	Vushtrri	Automatik me sinjale-nuk punon deri në lajmrin
10.	237+052	VK2	Prelluzhje	Automatik me bariera
11.	243+310	VK1	Obiliq	Automatik me bariera
12.	249+514	VK1	Fushë Kosovë	Automatik me bariera
13.	261+511	VK1	Lypian	Automatik me bariera
14.	263+485	VK2	Lypian	Automatik me bariera
15.	271+470	VK1	Bablak	Automatik me bariera
16.	280+672	VK1	Ferizaj	Automatik me bariera
17.	283+475	VK2	Ferizaj	Automatik me bariera
18.	300+626	VK1	Kaqanik	Automatik me bariera
19.	312+416	VK1	Hani i Elezit	Automatik me bariera
20.	04+840	VK1	Bardh	Automatik me bariera
21.	23+178	VK1	Drenas	Automatik me bariera
22.	55+698	VK1	Klina	Automatik me bariera
23.	56+108	VK2	Klina	Automatik me bariera

Vendkalimet e siguruar me pajisje automatike për sigurimin komunikacionit me sinjale rrugore ne vijat e hapura në km 213+298 dhe km 225+711 të cilat gjinden mes St. Mitrovicë- Vushtrri dhe Vushtrri –

Prilluzhë momentalisht nuk janë në funksion. Në VK-Mitrovicë në vitin 2008 shtëpiza me gjithë pajisje është demoluar nga pala e tretë dhe vlera e llogaritur është ~60,000,00 €. Në VK në Vushtrri janë të dëmtuar dhe të demoluar i sinjalet rrugore ato hapësinor dhe pikat kyçëse. Këto dëmtime janë bërë gjatë vitit 2009 dhe pasi nuk ka pasur trafik në atë pjesë nuk është insistuar për ti rregullua (që të mos dëmtohen prapë). Vendkalimet tjera përgjatë vijës hekurudhore Hani i Elezit-Leshak trajtohen si VK-gjysëautomatike pasi ato funksionojnë me formimin e rrugdhëtimit hyrës apo dalës nëpër stacione. VK në Vallaq që nga viti 2008 është goditur nga një kamion dhe është demoluar dhe nuk kemi informacione se a është rregullua se në bazë të lajmërimeve që kemi pasur aty dëmi ka qenë `90,000,00 Euro.

Vendkalimi elektrike i siguruar me gjysëmlaura dhe me sinjale rrugore që nuk është në mvarshmëri me rrugudhtimin, por hapja dhe mbyllja e vendkalimit bëhet me tastiera (me dore) nga stacioni në F. Kosove, km. 249+514.



Vendkalimet e mbrojtura me personel

Vendkalimi në Ferizaj te fabrika e gypave është i siguruar me personel dhe barriera mekani km 284+050.

Nxehja e ndërruesve ne Vendkalimet Zyrtare-stacione.

Në sistemet ekzistues sinjal-siguruese janë parapa pajisje shtesë që ndërrueset të funksionojnë dhe ta kenë sigurinë e lëvizjes së trenave edhe gjatë sezonit dimëror për këtë qëllim nëpër ndërruese janë instaluar nxehës elektrik.

- 1.Leshake. Nd.1,2,8 dhe 9.
- 2.Leposaviq Nd.1,2,4,dhe 5.
- 3.Sl.e Ibrit. Nd.1,2,3,dhe 4.
- 4.Vushtri. Nd.1,2,5,dhe 6.


- e) 5.Lypjan . Nd.1,2,3,4,dhe 6.
- f) 6.Prilluzhë. Nd.1,2,3,4,5,dhe 6.
- g) 7.Bablak. Nd.1,2,dhe 5.
- h) 8.Kaqanik. Nd.1,2,3,6, dhe 7.

Sistemi i Kontrollit të Trafikut -CTC

Ky sistem ka përfundua së instaluari gjatë viti 2009 dhe me ndihmën e këtij sistemi kontrollojmë stacionet e lidhura në këtë sistem (10 stacione Hani i Elezit - Mitrovicë). Përmes këtij sistemi janë indikacionet dhe komandat që mund të realizohen nga qendra. Në mënyrë permanente në monitor në qendrën CTC përcillet gjendja e pajisjeve në teren (sinjaleve, ndërrueseve, brezave të izolimit, vendkalimeve etj) përmes indikacioneve.



Qendra e CTC



Numëruesit e boshteve

Me qëllim të kontrollit të segmentit hekurudhor mes dy stacioneve janë instalua pajisjet e quajtura Numërues të boshteve. Me këtë sistem bëhet numërimi i boshteve të trenit në hyrje dhe dalje të segmentit hekurudhor dhe vlerat e lexuara krahasohen në mënyrë elektronike me vlerën e anuluar. Këto pajisje janë të instaluar në segmentet hekurudhore Hani i Elezit-Mitrovicë. Problemi më i madh në funksionimin e tyre po është dëmtimi i shpeshtë i kablllove se këto pajisje instalohen në zonën jashtë stacionit. Sistemi i numëruesve të boshteve shërben edhe për formimin e rrugëudhimeve në sistemin kur dy stacione lidhen në varshmëri. Kjo varshmëri mes stacioneve është instalua në segmentet hekurudhore Hani i Elezit-Lipian.



Numëruesi i boshteve


Detektorët për lëvizje të trenave

Me qëllim që të rritet siguria e lëvizjes së trenave gjatë vitit 2010 janë instalua detektorët për lëvizje të trenave përmes së cilëve detektohet treni kur kalon mbi sendor. Këta sensor lidhen në sistemin sinjalo-sigurues dhe me detektimin trenit formohet rrugudhtimi në hyrje.


Shërbimi i Telekomunikacionit

Për komunikim në rregullim të komunikacionit hekurudhor përdoren dy sisteme të komunikimit:

- 1.Sistemi i Radio-Lidhjeve
- 2.Sistemi transmetues i optikës
- 3.Rrjeti i telefonisë fikse
- 4.Video-sistemi



BLOK - DIAGRAM I PAISJEVE TELEKOMUIKUESE



Shtojca Nr.-7.Bllok-Diagrami I Paisjeve Telekomunikuese

Sistemi i Radio-Lidhjeve

Me këtë sistem mbulohet i tërë rrjeti hekurudhor i Kosovës dhe Vollkova hekurudhat e Maqedonisë. Me radiolidhje janë të pajisura të gjitha stacionet hekurudhore, me nga një bazë dhe me nga një radio dorë, po ashtu me RL janë të furnizuara edhe të gjitha lokomotivat dhe garniturat motorike të cilat janë në komunikacion.

Në regjistrofon regjistrohen:

Të gjitha kanalet e punës (1, 4 dhe 7) të radiolidhjeve, VHF
kanali i parë (1) UHF i radiolidhjeve,

Sistemi i Radio-Lidhjeve në funksion


Ky sistem është i organizuar përmes tri punkteve-repetitorëve

- a) Malet e Berishës –kanali 1,2 dhe 3
- b) Malet e Kaqanikut –kanali 4,5,6 dhe
- c) Maja e Cernushës - kanali 7,8,9

Sistemi transmetues i optikës

Gjatë vitit 2007/2008 në 18 stacionet janë vendos pajisjet aktive të optikës. Në sistemin transmetues përfshihen pajisjet aktive të optikës dhe kablli optik. Realizimi i lidhjeve është bërë përmes kabllit optik i cili është i shtrirë përgjatë vijës hekurudhore Hani i Elezit-Fushë Kosovë-Prishtinë, Fushë Kosovë-Mitrovicë, Fushë Kosovë-Klinë-Pejë dhe Klinë-Prizren. Kjo kabllo është pronësi e PTK-së por me marrëveshje HK-PTK për nevoja të Hekurudhës përdoren 4 fije optike të cilat i plotësojnë nevojat e hekurudhës. Paralel me kabllin e cekur është edhe kablli optik i KONET-it i cili për momentin nuk është në funksion.

Përmes sistemit transmetues është realizuar edhe rrjeti i intranetit ku janë të lidhura të gjitha stacionet e cekura ku ka pajisje optike.



Traseja e kabllit optik

Rrjeti i telefonisë fikse

Lidhjet telekomunikuese janë të realizuara përmes pajisjeve aktive të optikës të instaluar nëpër stacionet të lidhura me kabllon optik. Këto lidhje telekomunikuese janë të realizuara përmes centralit dixhital me kapacitet deri në 400 numra në Fushë Kosovë.

Lidhjet të cilat personeli i trafikut i ka në dispozicion janë:

1. Lidhja e punës
2. Lidhja TAH,
3. Lidhja direkte A
4. Lidhja direkte B

Operativa dhe Stacioni i Fushë Kosovës e kanë në dispozicion e dhe lidhjen emergjente grupore për të gjitha stacionet.

Po ashtu tani ekziston mundësia e kyçjes së të gjitha stacioneve ku ekziston linje e TAH-ut të kyçet edhe në linjat publike (PTK).

Bllokut në Fushë Kosovë dhe në Miradi janë të furnizuar me lidhje telefonike të punës. Vendkalimi në Ferizaj është po ashtu i pajisur me lidhje telefonike të punës. KEK-u është i pajisur me një linjë induktive me stacionin e Kastriotit.

Bëhet incizimi i të gjitha linjave të punës, të stacioneve, të bllokove dhe operativës janë të kyçura në regjistrofon dhe incizohen.

Pra të gjitha linjat të cilat përdoren për rregullimin e trafikut hekurudhor incizohen.

Video-sistemi

Me qëllim të vëzhgimit dhe mbajtës nën kontroll të disa stacioneve është bërë instalimi i video-sistemit ku nga Fushë Kosovë përmes monitorit shihet stacioni në tri pozicione me një pamje dinamike. Ky sistem është shumë i nevojshëm e ndoshta në të ardhmen do të instalohet edhe në objektet përgjatë hekurudhës të cilat mund të paraqesin rrezikshmëri gjatë lëvizjes së trenave.

Shërbimi i Energjetikës

Për shkak të reduktimeve nga ana e KEK-ut shpesh paraqiten problemet në furnizim me energji elektrike. Ka stacione ku furnizimi i stacioneve bëhet nga trafo e hekurudhës 10/04 kv por kemi edhe stacione ku furnizimi bëhet nga rrjeti i qytetit. Në disa stacione janë edhe Dizel-gjeneratët. Gjatë vitit 2011 janë bërë ndërrimet e Dizel-gjeneratët të vjetër me Dizel-gjeneratët të rinj të cilët janë me kualitet në nivel të zhurmës dhe mund të monitorohen dhe kontrollohen nga qendra prej ku monitorohen.

Është bërë testimi i tokëzimeve punuese dhe mbrojtëse dhe lëshuesja e atesteve në të gjitha stacionet hekurudhore.

Nr	Stacionet	Ka trafo 10/04kv	Ka Diesel-Gjenerator
1.	Fushë Kosovë-Nyja	8 trafo	2+1
2.	Lypian	1	1
3.	Bablak	1	1
4.	Ferizaj	1	1
5.	Gurëza	1	1

6.	Kaqaniku	1	1
7.	Hani I Elezit	1	1
8.	Obiliqi	1	1
9.	Prelluzhje	1	1
10.	Vushtrri	1	1
11.	Mitrovica	1	1
12.	Zveqani	1	1
13.	Sllatina	1	1
14.	Leposaviqi	1	1
15.	Leshaku	1	1
16.	Prizreni	1	-

Me ndarjen e Hekurudhave të Kosovës me 01.09.2011 në Infrakos dhe Trainkos me qëllim të matjes së shpenzimeve energjetike në trafo ku operon Trainkosi janë instalua grupet matëse në trafo 10/04 kV pasi furnizimi vije direkt nga trafoja 35 kV nga KEK-u në Fushë Kosovë.

Stacionet të cilat furnizohen nga rrjeti i qytetit janë: Besiana, Bardhoshi, Prishtina, Bardhi, Drenasi, Klina, Peja.

Përveç problemit të reduktimeve nga KEK-u po kemi problem edhe me nivelin e tensionit në disa stacione (Mitrovicë, Gurëz, Prelluzhje) ku si shkak po vjen deri te mosfunksionimi i pajisjeve SS. i kemi vendosë edhe korrektorët e tensionit

Gjendja teknike e vijave hekurudhore dhe objekteve përcjellëse të cilat janë funksionale dhe zhvillohet komunikacioni hekurudhor janë në gjendje të mirë teknike përveç 5 tuneleve në grykën e Kaçanikut të cilët janë në gjendje jo të mirë teknike.

Ky keqësim është prezent në pjesët e mureve të themeleve dhe të harqeve të larta të tuneleve e për shkak të vjetërsisë së ndërtimit dhe oksidimit të materialeve të përdorura gjatë ndërtimit (janë ndërtuar gjatë periudhës 1870-1874) e këto pjesë janë maksimalisht të dëmtuara deri në fazën e vetë shkatërrimit. Kjo gjendje në mënyrë direkte e rrezikon sigurinë e komunikacionit hekurudhor.

Tunelet tek të cilët është kjo prezencë janë: tuneli “Runjevë” l=150,49m, Guri i shpuar” l=91,40m , “Gaire” l=198,22m , “Valan”l=264,60m. dhe “VII” l=126,42m.

Tuneli Gajre është në fazën e rekonstruktimit.

Linja hekurudhore Leshak – Hani i Elezit e kategorizuar në kategorinë D-3 me shtypje boshtore 22.5 t dhe shtypje gjatësore 7.2 t/m.

Shpejtësia e realizuar në këtë linjë hekurudhore është Mitrovicë - Fushë Kosovë 60 km/orë.

Fushë Kosovë - Gurëzë.70 km/orë, Gurëzë- kufiri me Maqedoni.....60 km/orë.

Linja hekurudhore Fushë Kosovë- Pejë e kategorizuar në kategorinë C-2 me shtypje boshtore 20.0 t dhe shtypje gjatësore prej 6.4 t /m.

Shpejtësia e realizuar në këtë linjë hekurudhore është stacionit Fushë Kosovë – Klinë ...60 km/orë.
Prej stacionit Klinë - Pejë70 km/orë

Linja hekurudhore Klinë – Prizren Km: 0+000 - 13+800 e kategorizuar në kategorinë D-3 me shtypje boshtore 22,5 t dhe shtypje gjatësore 7,2 t/m¹.

Shpejtësia e lejuar është.....30 km/orë **Prej km:13+800-58+831 Prizren** e kategorizuar në kategorinë B-1 me shtypje boshtore prej 18.0 t. dhe shtypje gjatësore prej 5.0 t/m¹.

Shpejtësia e lejuar prej km. 13+800-35+910 është:..... 20 km/orë.

Linja prej km. 35+910 st. Xerxe - Prizren përkohësisht jashtë përdorimit.

Linja hekurudhore Fushë Kosovë- Bardhosh është e kategorizuar në kategorinë D-3 me shtypje boshtore prej 22.5 t. dhe shtypje gjatësore 7.2 t/m¹.

Bardhosh – Prishtinë shpejtësia e lejuar..... 30 km/orë

Prishtinë – Fushë Kosovë shpejtësia e lejuar50 km/orë

Linja Bardhosh-Livadhi përkohësisht jashtë përdorimit.

Hekurudha industriale Bardh- Magurë është e kategorizuar në kategorinë C-2 me shtypje boshtore prej 20.0 t. dhe shtypje gjatësore 6.4 t./m¹.

Stacioni Bardh km. 0+000 – stacioni Medvec/Feronikel shpejtësia e lejuar.....30 km/orë

Linja Medvec/Feronikel-Magur përkohësisht jashtë përdorimit.

Hekurudha industriale Miradi - Badovc është e kategorizuar në kategorinë C-2 me shtypje boshtore prej 20.0 t. dhe shtypje gjatësore 6.4 t/m¹

Ndërruesja në hekurudhë të hapur km. 254+464 -Graqanicë km. 3+20020 km/orë **Prej km. 3+200 – Badovc përkohësisht jashtë përdorimit**

Për sigurinë e lëvizjes së trenave në linjat e lart cekura në vitin 2011 janë realizuar punët si në vijim:

- kontrollimet vizuale të linjave dhe objekteve përcjellëse.
- kontrollimet teknike të stabilimenteve.
- Pastrimet e profilit të lirë, kanaleve ujë përcjellëse dhe lëshesave.
- Plotësimi i linjave hekurudhore me ballast.
- Rregullimi i gjeometrisë së binarit.
- Ndërrimi i traversave në binar, ndërruese dhe ura.
- Ndërrimi i shinave nëpër kthesa.
- Vëzhgimi i binarit në temperatura të larta.

Remontimi i binarit të koroduar në tunelin Baicë

8.3. ARH NE FUNKSION TE RREGULLIMIT TE TREGUT

Deri tani nuk ka pasur infrastrukture ligjore dhe as kushte te nevojshme per te pasur zhvillim te tregut ne kete sektor, Bordi i ARH-së ka draftuar disa nga rregulloret per departamentin qe duhet ta mbulon kete sektor, mirëpo ne mungese te mjeteve ARH nuk ka mundur te rekrutoj personelin e nevojshem per kete departament, qe nekuptohet se puna e deri tanishme si institucion ne konsolidim ka marrur informatat e nevojshme gjate monitorimit te kompanise HK . Vlene te theksohet se roli i Rregullatorit do te rritet dhe do te jet i domosdoshem me ndarjen e kompanise HK ne dy kompani te reja.

8.3.1 Linjat e operimeve për vitin 2011

		2011		
Nisjet	TRENI	Relacioni Prej	Relacioni Mes	Relacioni Deri
07:10	891	PR	H. Elezi	SHKUP
16:35	892	SHKUP	H. Elezi	PR
04:15	4101	Fushe Kosove		H. Elezi
05:48	4100	H. Elezi		Fushe Kosove
10:50	4102	H. Elezi		Fushe Kosove
15:30	4103	Fushe Kosove		H. Elezi
18:48	4105	Fushe Kosove		H. Elezi
20:35	4104	H. Elezi		Fushe Kosove
05:32	760	Peje	Fushe Kosove	PR
16:30	761	PR	Fushe Kosove	Peje
07:50	4201	PR	Fushe Kosove	Peje
12:10	4200	Pej	Fushe Kosove	PR
10:00	55981	Miradi		H. Elezi
14:30	55980	H. Elezi		Miradi
17:00	55983	Miradi		H. Elezi
22:45	55982	H. Elezi		Miradi
04:24	57860	Drenas		Medvece
07:00	57861	Medvece		Drenas
12:15	57862	Drenas		Medvece
15:10	57863	Medvece		Drenas
20:30	57864	Drenas		Medvece
23:29	57865	Medvece		Drenas

Në vazhdim ju paraqesim çmimoren e relacioneve në formë tabelore për Trenin e Pejës , Trenin e Hanit të Elezit dhe Trenin e Shkupit:

8.3.2 Çmimorja e rregullt e trenit të Pejës (TP)

Çmimet e dhëna në Euro	Prishtinë	Fushë Kosovë	Bardh	Drenas	Klinë
Pejë	3.00	2.80	2.50	2.20	0.80
Klinë	2.20	1.80	1.80	1.20	
Drenas	1.00	0.80	0.50		
Bardh	0.50	0.30			
Fushë Kosovë	0.30				

8.3.3. Çmimorja e rregullt e trenit të Hanit të Elezit dhe Shkupit (IC)

Çmimet e dhëna në Euro	Prishtinë	Fushë Kosovë	Lypjan	Ferizaj	Kaçanik	Hani i Elezit
Shkup	4.00	3.70	3.30	2.70	2.00	1.50
Hani Elezit	2.50	2.20	1.80	1.20	0.50	
Kaçanik	2.20	1.80	1.50	0.50		
Ferizaj	1.50	1.20	0.80			
Lypjan	0.50	0.50				
Fushë Kosovë	0.30					

8.3.4. Kapaciteti i vagonave

Seria vagonit	Lloji	Gjatësia ngark.	Gjerësia ngark.	Sipërf. ngark.	Vëllimi vagonit	Numri bosht.	Numri dyerve	Lartësia kanatave	Masat vagonit	Ngarkues. e vag.
		m	m	m2	m3			m	t	t
E	hapur	8,76	2,76	24,00	36,00	2	2	1,5	10,00	21,00
Eas	hapur	12,80	2,76	35,07	70,60	4	4	2,00	22,00	42,00
Gbs	mbyllur	12,70	2,60	33,00	75,90	2	2		12,60 14,00	18,00
Gas	mbyllur	15,25 15,50	2,60	39,60 40,30	90,40 92,00	4	4		22,50	41,50
Gkks	mbyllur	11,20	2,60	29,00	66,70	2	2		11,70 14,50	17,00 20,00
Galms	mbyllur	12,42	2,63	32,60	75,10	4	2		22,70	41,30
Zas	vagon cistern				60,00	4			24,30	40,00
Fals	hapur	6,90	2,60		26,00	4	4		23,00	40,50
Regs	Për kontej.	18,50	2,77	51,00		4		0,40	23,40	
U-a1						4			23,50	40,00
B/KL II	Vagon udhëtar	16,60		63 ulëse		4	4		43,00	46,00

8.3.5 Regjistri i mjeteve Lëvizëse

Nr.	Përshkrimi	Gjendja
1	Lokomotive 645-033 (001)	Në operim
2	Lokomotive 661-228 (003)	Në operim
3	Lokomotive Di 3619 (005)	Në operim
4	Lokomotive Di 3633 (006)	Në operim
5	Lokomotive Di 3641 (007)	Në operim
6	Lokomotive Di 3643 (008)	Në operim
7	Lokomotiva G 1700 (009)	Në operim
8	Lokomotiva G16 (010)	Në operim
9	Tren Motorik tipi 1281-01	Në operim
10	Tren Motorik tipi:1304-02	Në operim
11	Tren Motorik tipi:1306-03	Në operim
12	Tren Motorik tipi:1313-04	Në operim

13	Lokomotiva Manovruese MDD 2-01	Në operim
14	Lokomotiva Manovruese MDD 3-02	Në operim
15	Lokomotive 668-1528 TM	Jashtë operimi
16	Lokomotive 668-1531 TM	Jashtë operimi
17	Lokomotive 668-1534 TM	Jashtë operimi
18	Lokomotive 6300-15 6	Jashtë operimi
19	Lokomotive 6300-18 6	Jashtë operimi
20	Lokomotive 548-lokom	Jashtë operimi
21	Lokomotive 661-261	Jashtë operimi
22	Lokomotive 664-062	Jashtë operimi
23	Lokomotive 641-111	Jashtë operimi
24	Lokomotive 641-112	Jashtë operimi
25	Lokomotive 641-122	Jashtë operimi
26	Lokomotive 641-203	Jashtë operimi
27	Lokomotive 641-212	Jashtë operimi
28	Lokomotive 734-031	Jashtë operimi
29	Lokomotive 734-109	Jashtë operimi
30	Vagon E 01835000896-9	Në operim
31	Vagon E 01835011756-2	Në operim
32	Vagon E 01835006437-6	Në operim
33	Vagon E 01835017737-6	Në operim
34	Vagon E 01835018923-1	Në operim
35	Vagon E 01835017168-4	Në operim
36	Vagon E 01835006192-7	Në operim

37	Vagon E 01835014659-5	Jashtë operimi
38	Vagon E 01835072704-8	Në operim
39	Vagon E 01835006798-1	Në operim
40	Vagon E 01835010504-7	Jashtë operimi
41	Vagon E 01835019726-7	Jashtë operimi
42	Vagon E 01835010458-6	Jashtë operimi
43	Vagon E 01835009388-8	Jashtë operimi
44	Vagon E 01835001025-4	Jashtë operimi
45	Vagon E 01835008144-6	Në operim
46	Vagon E 01835019796-0	Jashtë operimi
47	Vagon E 01835015550-5	Jashtë operimi
48	Vagon Gbs 21741502829-9	Në operim
49	Vagon D 6275	Jashtë operimi
50	Vagoni Nr.5101	Jashtë operimi
51	Vagoni Nr.5109	Në operim
52	Vagoni Nr.5165	Në operim
53	Vagoni Nr.5098	Në operim
54	Vagoni Nr.5113	Jashtë operimi
55	Vagoni Nr.5163	Në operim
56	Vagoni Nr.5112	Jashtë operimi
57	Vagoni Nr.5097	Jashtë operimi
58	Vagoni Nr.5162	Jashtë operimi
59	Vagoni Nr.5096	Jashtë operimi
60	Vagonat austriak -50812935675-6	Në operim

61	Vagonat austraik -50812935714-3	Në operim
62	Vagonat austraik- 50812935548-5	Jashtë operimi
63	Vagonat austraik- 50812935749-9	Në operim
64	Vagonat austraik- 50812935507-1	Në operim
65	Vagonat austraik- 50812935411-6	Në operim
66	Vagonat austraik- 50818235426-8	Jashtë operimi
67	Vagonat austraik -50812935535-2	Jashtë operimi
68	Vagonat austraik -50818235428-4	Jashtë operimi
69	Vagonat austraik- 50818235421-9	Jashtë operimi
70	Vagon Gs 42721202294-6	Jashtë operimi
71	Vagon Gbs 21721500349-2	Jashtë operimi
72	Vagon Gbs 42721501052-6	Jashtë operimi
73	Vagon Gbs 21721502531-3	Jashtë operimi
74	Vagon Gbs 42721502593-8	Jashtë operimi
75	Vagon Gbs 21721502662-6	Jashtë operimi
76	Vagon Gbs 21721503425-7	Jashtë operimi
77	Vagon Gbs 21721503566-8	Jashtë operimi
78	Vagon Gbs 21721503676-5	Jashtë operimi
79	Vagon Gas 31721900388-2	Jashtë operimi
80	Vagon Gas 31721900412-2	Jashtë operimi
81	Vagon Gas 31721900463-5	Jashtë operimi
82	Vagon Gas 31721901022-8	Jashtë operimi
83	Vagon E 21725003330-5	Jashtë operimi
84	Vagon Es 21725550791-5	Jashtë operimi

85	Vagon Gbs 21721502541-2	Jashtë operimi
----	-------------------------	----------------

8.3.1. Memorandumi me Komisionin e Konkurences

ARH si përgjegjesi tjetër institucionale dhe ligjore ka edhe rregullimin e tregut në sektorin e Hekurudhave, nisur nga kjo bazë dhe faktin se ekziston edhe një institucion tjetër Komisioni Kosovar i Konkurrencës që ka përgjegjesi në zhvillimin e ekonomisë së tregut për të gjitha industritë në nivel vendi, atëherë Bodi i ARH-së ka kërkuar edhe zyrtarisht bashkëpunimin me këtë institucion pra me Komisionin Kosovar të Konkurrencës me mundësi që përmes një memorandumi si dokument zyrtar të jemi të koordinuar dhe të harmonizuar me rregullativen ligjore në Sektorin e Hekurudhave.

9. CESHTJET TEKNIKE DHE HETIMI I AKSIDENTEVE HEKURUDHORE

Meqenëse numri i incidenteve dhe aksidenteve në trafikun hekurudhor në vend nga viti në vit po shënon ngritje, ka qenë parësore për hetuesit e këtij departamenti që të krijojnë një ambient të sigurt për qytetarët në fushën e sigurisë së komunikacionit hekurudhor. Prandaj, ngritja e sigurisë hekurudhore me qëllim të ruajtjes së jetës dhe shëndetit të qytetarëve duhet të shoqërohet me mbështetje ligjore, institucionale, teknike, financiare dhe bashkëveprim institucional.

Departamenti i Hetimit të Aksidenteve që nga themelimi e deri më sot ka tentuar të kontribuojë në aspektin e ngritjes së kapacitetit të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave. Konsiderojmë që edhe viti 2011, vit që po e lëmë pas e përcolli këtë departament me obligime dhe detyra të cilat rezultuan pozitivisht gjatë kësaj periudhe fal, angazhimit dhe profesionalizmit. Ishte kjo një periudhë e sukseseve dhe sfidave të ndryshme. Kur e themi vit i sukseseve, këtë e mbështesim në perceptimet e rezultateve duke marrë departamentin si ndikues në ngritjen e performancës së ARH-së. Periudha e kaluar po ashtu është e njohur si sfiduese për organizatën, meqë ajo duke vazhduar me konsolidimin e vazhdueshëm të kapaciteteve të saj.

Për periudhën që raportohet, stafi i këtij departamenti ka zhvilluar një numër të konsiderueshëm të inspektimeve, vizitave si dhe është marrë me analizen e disa rasteve të hetuara nga ekspertet e kompanisë hekurudhat e Kosovës.

Gjatë vitit 2011 Departamenti i Hulumtimit të Aksidenteve dhe Menaxhmenti i ARH-së kanë pranuar raportet e komisionit hetues nga hekurudhat e Kosovës për aksidentet e ndodhura. ARH-ja ka bërë analizë, shqyrtime si dhe ka dhënë mendime profesionale dhe rekomandime sigurie për parandalimin e këtyre aksidenteve hekurudhore.

Aksidentet hekurudhore të ndodhura gjatë vitit 2011				
Nr.	Data	Ora	Vendi	Raporti
1	25.01.2011	16:06	Fushë Kosovë - Lypian	PO

2	15.03.2011	21:37	Bablak - Lypian	PO
3	16.05.2011	10:48	KEK - Kastriot	PO
4	15.06.2011	15:45	Fushë Kosovë - Leshak	PO
5	19.07.2011	15:54	Fushë Kosovë - Hani I Elezit	PO
6	24.07.2011	14:43	Prishtinë - Fushë Kosovë	PO
7	02.08.2011	09:10	Fushë Kosovë-Pejë	PO
8	08.08.2011	11:05	Fushë Kosovë-Pejë	PO
9	22.08.2011	16:00	Fushë Kosovë	PO
10	02.09.2011	09:52	Fushë Kosovë-Pejë	PO
11	13.09.2011	17:15	Bardhë-Medvec	PO
12	10.10.2011	09:30	Fushë Kosovë-Pejë	PO
13	18.11.2011	07:13	Fushë Kosovë	PO
14	28.11.2011	23:15	Gajre-Hani I Elezit	PO
15	08.12.2011	12:38	Pejë – Fushë Kosovë	PO
16	15.12.2011	21:40	Bablak – Binari Industrial HIB	PO
17	24.12.2011	18:40	Në hyrje të stacionit Ferizaj	PO

10. ARH NE REGJION NE KONFERENCA NDERKOMBETARE DHE TRAJNIMET

ARH gjate vitit 2011 ka planifikuar nje agjende te udhetimeve ne regjion por te vetedijshem per buxhetin modest nuk ka mundur ti realizoj te gjitha, si prioritet ka realizuar në Gusht 2011 Vizitë në Agjencionin Rregullativ të Hekurudhave në Republikën e Maqedonisë. Qëllimi i vizitës ka qenë, njoftimi dhe shkëmbimi i informatave dhe përvojave në mes Agjencionit Rregullativ Hekurudhor të Republikës së Maqedonisë dhe Autoritetit Rregullativ Hekurudhor të Republikës së Kosovës. Kete takim e ka perfaqesuar drejtori i pergjithshem i ARH-se.

Në mars 2011 pjesëmarrja në trajnimin, Menaxhimi dhe ekzekutimi i shpenzimeve publike nga OB në Kosovë, qëllimi dhe objektivat kryesore ishin menaxhimi ekzekutimi i shpenzimeve në mënyrë efikase dhe efektive nga OB sipas rrjedhës dhe proceduarve konform ligjit mbi menaxhimin e financave publike L/048/2008 si në pjesën e legjilacionit, menaxhimit financiar dhe kontrollit, Sistemit informative për

menaxhimin e financave, planit kontabël, procesit buxhetor dhe raportimit. Trajnimi është mbajtur në Ohër, Maqedoni.

Në mars 2011 pjesëmarrja në trajnimin, Rekrutimi i resurseve njerëzore sipas ligjit të shërbyesve civil, trajnimi është mbajtur në Ohër, Maqedoni.

Në mars 2011 pjesëmarrja në Konferencën ndërkombëtare të navigimit satelitor në Munih të Gjermanisë e organizuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit e Gjermanisë ka pasur si subjekt organizimin Evropian rreth sistemit satelitor të navigimit dhe lëvizjes së mjeteve transportuese duke pasur parasysh zhvillimin e hovshëm të teknikes së navigimit. Fushat tipike të zhvillimit, ku do të vëreheshin lehtësira të mëdha për përdoruesin me rastin e aplikimit të sistemit të navigimit janë: Sistemi i pozicionimit dhe informimit për transport publik lokal.

Në mars 2011 pjesëmarrja në Konferencën ndërkombëtare 'Next Station' 2011 Pas edicionit të suksesshëm në Romë (2005) dhe Paris (2007), Konferenca e 3 ndërkombëtare është zhvilluar në Bruksel, më 16, 17 dhe 18 mars 2011. Kjo ka qenë e profilit të lartë ngjarje globale hekurudhore që është paraqitur nga SNCB Holding në bashkëpunim të ngushtë me Unionin Ndërkombëtar të Hekurudhave (UIC). Ndër temat që janë adresuar në prani të nivelit të lartë folës nga e gjithë bota janë: zhvillimin e projekteve dhe financimin, menaxhimin e stacionit, objekteve dhe planit urbanistik, përdorimin komercial të hapësirës stacionit dhe shërbimeve, multimodale dhe bashkëpunimi me mënyrat e tjera të transportit hekurudhor. Next Station 2011 është një vend takimi nga e gjithë bota për të gjithë drejtuesit e stacioneve hekurudhore, ofruesit e shërbimeve, zhvilluesit e projektit, agjencitë e hulumtimit, gazetarët e specializuar me pak fjalë, të gjithë ata që kanë të bëjnë me transport hekurudhor.

Në Prill 2011 pjesëmarrja në trajnimin për Menaxher të Projekteve të BE-së të Certifikuar nga Asociacioni Evropian për Certifikime dhe Kualifikime (ECQA), nga data 06 — 09 Prill 2011, në Tiranë, Shqipëri. Ky trajnim është organizuar nga Instituti Kosovar për Menaxhim në bashkëpunim me Skiles Internacional nga Austria për herë të parë në Republikën e Kosovës dhe i njëjti është i akredituar, validuar dhe certifikuar ndërkombëtarisht nga European Certification and Qualification Association ECQA. Gjatë trajnimit janë elaboruar dhe trajtuar disa raste konkrete që kanë të bëjnë me Menaxhimin e Projekteve të BE-së dhe të njëjtat janë komentuar edhe në aspektin teorik, që d.m.th: se element mjaft me rëndësi që e karakterizon këtë trajnim ka qenë kombinimi i pjesës praktike dhe teorisë së Menaxhimit të Projekteve të BE-së.

Në tetor 2011 pjesëmarrja në trajnimin Menaxhimi i shpenzimeve publike dhe përgatitja e pasqyrave financiare Stamboll, Turqi.

Në nëntor 2011 pjesëmarrja në vizitën studimore në Francë në qendrat industriale dhe institucionale në Paris, Lion dhe po ashtu në Holandë e organizuar dhe financuar nga ZNKE dhe implementuese asistencë teknike Egis-BCEOM. Vizita studimore është orientuar në qytetet Hagë, Utrecht dhe Amsterdam të Holandës. Në kuadër të projektit të financuar ZNKE, ka pasur për qëllim marrjen e përvojës dhe informatave rreth hartimit të Strategjisë së Transportit MultiModal.

Qëllimi i kësaj strategjie për Transportin Multimodal është kontribimi në rritjen ekonomike përmes krijimit të sistemit të transportit multimodal (rrugor, hekurudhor, dhe ajror) të integruar, efikas, dhe me kosto të ulët, i cili nuk e rrezikon ambientin. Strategjia dhe Plan i Veprimt ka për qëllim të përcaktojë zhvillimin afatgjatë të sektorit të transportit në Kosovë.

Vlen të theksohet se ka qenë një bashkëpunim shumë i mirë në nivel institucional në mes dy shteteve për sa i përket prezantimeve dhe debateve.

Përfaqësuesit e ARH-së kanë marrë pjesë rregullisht në takimet dhe punëtoritë e sektorit të transportit të organizuara nga qeveria. Një bashkëpunim i veçantë ndërinstytucional është zhvilluar ndërmjet Ministrisë së Infrastrukturës, Kompanisë Hekurudhat e Kosovës, zyrës ndërlidhëse të Komisionit Evropian dhe ARH-së, në takimet e Komitetit Drejtues të projektit për Përkrahjen në zbatimin e marrëveshjes së komunitetit të transportit si dhe në takimet dhe punëtoritë për Hartimin e Strategjisë së Transportit Multimodal dhe Planit të veprimit.

Po ashtu gjatë vitit 2011 stafi i ARH ka mbajtur trajnime të ndryshme në Administratën e përgjithshme nga Instituti Kosovar për Administratë Publike.

10.1. TRYEZA E RRUMBULLAKET NE KROACI

ARH ka marrur pjese ne takimin i trupave rregullatorë të tregut dhe shërbimeve hekurudhore në Evropën Juglindore ne Zagreb të Kroacisë 19-20 maj 2011. Shpenzimet e udhetimit dhe qëndrimit atje i ka financuar ZNKE.

Në fillim të takimit u bë miratimi i deklaratës së përbashkët të trupave rregullator të tregut dhe të shërbimeve hekurudhore të Evropës Juglindore sipas direktives 2001/14/KE Komisionit Evropian. Deklarata u nënshkrua nga Kryesuesi i Bordit të ARH-se.

- Pastaj u miratua katalogu informues i trupave rregullator dhe shërbimeve hekurudhore në Evropën Juglindore.
- U vazhdua me aktivitetin e rregullatorëve për periudhën e kaluar një vjeçare .
- Për gjendjen në treg etj.

Të gjithë përfaqësuesit (pjesëmarrësit) raportuan për gjendjen , vështirësitë dhe të arriturat në autoritetet rregullative të hekurudhave. Në këtë pike u fol edhe për tregun dhe ligjet e tregut dhe si përfundim doli se këto janë ato që na lidhin dhe na ofrojnë me BE-në .Qeveritë pos ligjeve duhet që të sigurojnë hekurudha të sigurt , kualitative , moderne dhe shërbime konkurruese si dhe të bëhet më shumë në nivelizimin e çmimeve , të hiqet monopoli ,dhe si rezultat të kemi liberalizimin e tregut. Në takim iu kushtua rëndësi edhe katalogut të informimit , u vendos që kjo të jetë punë e të gjithë pjesëmarrësve të publikohet nëpërmjet një faqeje të komunikimit <http://www.regulatori-jie.com/>

Hekurudhat nuk duhet të jenë më vetëm nacionale , duhet të hapen. Direktivat e EU-së na shtyjnë që të hapemi dhe të bashkpunojmë , format më të mira janë bashkpunimi dhe shkëmbimi i përvojave. Temë e trajtimit ishte edhe çështja e rrjetit hekurudhor , shpenzimet e energjisë elektrike dhe stacioneve hekurudhore , ku pjesëmarrësit paraqitën vështirësitë të cilat i përcjellin këto segmente , e të cilat ishin po thuajse të njëjta për gati të gjithë.

-  Poliset e sigurimit nuk janë të definuara .
-  Mënyra se si janë të rregulluara lëshimet e licencave veç e veç.
-  Trupat rregullator a duhet të merren edhe me ankesa.

Për qështje të sigurisë kërkesa nga pjesëmarrësit ka qene se duhet të definohet dhe mundesisht pagesat të jenë të njëjta . Duhet të ketë një dokument të përbashkët për shpenzime të qarkullimit të trenave në infrastrukturë dhe vlera e shpenzimeve minimale që duhet të pranohet. Edhe ndarja e traseve ishte temë që u diskutua, traset u ndahen operatorëve. Kërkesa për trase duhet të rregullohet me akte nënligjore dhe ndarja e tyre duhet të jetë kompetencë e rregullatorëve.

Kryesuesi i Bordit ka mbajtur edhe një prezentim për gjendjen e hekurudhave dhe ARH-se si dhe për kornizën ligjore në Republikën e Kosovës në sektorin e hekurudhave. Vlene të përmendet se në takim kemi marrur pjesë si Kosovë të përfaqësuar edhe me flamurin e Kosovës zyrtarisht.

10.2. SETTO- Observatori i Transportit i Evropës Juglindore

Observatori i Transportit i Evropës Juglindore (South East Europe Transport Observatory-SEETO) është organizatë rajonale transporti themeluar me Memorandumin e Mirëkuptimit për zhvillimin e Rrjetit Qendror Rajonal të Transportit (MM) të nënshkruar 11 qershor 2004 nga ana e qeverive të Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovina, Kroacia, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi, Kosovës dhe Komisionit Evropian.

Qëllimi i SEETO-s është që të promovojë bashkëpunimin në zhvillimin e infrastrukturës kryesore dhe ndihmëse të Rrjetit multimodal të Evropës Juglindore, Transportit Rajonal si dhe për të promovuar dhe për të përmirësuar kapacitetin lokal për zbatimin e programeve të investimeve, menaxhimin dhe grumbullimin e të dhënave dhe analizimin e tyre për rajonin dhe rrjetin kryesor të transportit .

Përpyjekjet e Komisionit Evropian janë të përqendruara në tri fushat kryesore të cilat janë vendimtare për zhvillimin e përgjithshëm të qëndrueshëm dhe konkurrues të transportit **hekurudhor** (1) hapjen e tregut të transportit hekurudhor dhe të konkurrencës, (2) përmirësimin e interoperabilitetit dhe sigurinë e rrjeteve kombëtare dhe (3) zhvillimin e infrastrukturës të transportit hekurudhor.



Harta Rrjeti kryesor hekurudhor ku shihen lidhjet në mes të Shqipërisë, Bosnjë dhe Hercegovinës, Kroacisë, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbisë, Malit të Zi dhe Kosovës.

11. KËRKESAT PËR BUXHET DHE PËRKRAHJE

Gjatë vitit 2011 ARH është përballur me mungesë të buxhetit të mjaftueshëm sipas kërkesave ligjore si organizatë e pavarur buxhetore, andaj ka kërkuar mbështetje të vazhdueshme financiare nga institucionet përgjegjëse për financimin e ARH-se dhe po ashtu nga fondet e organizatave ndërkombëtare që veprojnë në Kosovë sidomos në perkrahjen për financimin e stafit të nevojshëm dhe eksperteve të nevojshëm dhe të rëndësishëm për sektorin që në mbikeqym.

Ka zhvilluar takime me nivele të ndryshme institucionale vendore dhe ndërkombëtare për të siguruar mbështetje financiare për nevojat dhe kërkesat e institucionit.

12. ANEKSET

Shkresat drejtuar institucioneve të bashkangjitura :

Me datë 07.02.2011 Buxheti 2011, per Autoritetin Rregullativ i Hekurudhave

Me datë 21.03.2011 Kerkese per rishqyrtim te Qarkores dhe Buxhetit për vitin 2011-2013

Në shtator 2011 ARH ka kerkuar edhe mbështetje financiare nga fondi Soros (Capacity Development Facility (CDF).

Me date 23.06.2011, Kërkesë për hapësirë për zyre, Ministrisë së Administratës Publike

Me date2011 kërkesë për huazim të një automjeti